



ALBSIG
INVEST



PROSPEKT
FONDI I PENSIONIT PRIVAT
SMART PENSION

PËRMBAJTJA E LËNDËS

1.	INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME.....	5
2.	PËRKUFIZIME	7
3.	POLITIKA E INVESTIMIT DHE ADMINISTRIMI I RREZIKUT	8
3.1.	Politika e Investimit	8
3.2.	Shpërndarja e Aktiveve	10
4.	INFORMACIONI MBI FONDIN DHE PERFORMANCËN E TIJ	10
4.1.	Të dhënat historike.....	11
4.2.	Shpërndarja e aktiveve më 31 Dhjetor 2024.....	11
5.	RREZIQET KRYESORE TË INVESTIMIT NË FOND	12
5.1.	Rreziku i Tregut:	12
5.2.	Rreziku i Inflacionit:	13
5.3.	Rreziku i Kredisë:	13
5.4.	Rreziku i Likuiditetit:.....	13
5.5.	Rreziku Operacional:	14
5.6.	Rreziku i Përputhshmërisë:	14
5.7.	Rreziku i Reputacionit:	14
5.8.	Rreziku i Agjencisë:.....	14
5.9.	Rreziku i Ndryshimit të Tatimit:	15
5.10.	Rreziku Ligjor:.....	15
5.11.	Rreziku Politik:	15
5.12.	Përmbledhja e ndikimit të rreziqeve	15
6.	PROCESI I ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT	15
7.	ANËTARËSIMI DHE TË DREJTAT E ANËTARIT	16
8.	KONTRIBUTET E ANËTARËVE NË FONDIN E PENSIONIT	17
9.	TRAJTIMI TATIMOR	18
9.1.	Lehtësitë tatimore për Anëtarin.....	18
9.2.	Lehtësitë tatimore për kontributet e bëra nga punëdhënësi.....	19
10.	PAGESA E PENSIONEVE	19
10.1.	Pagesa e Pensioneve Sipas Parashikimeve në Ligj	19
10.2.	Tërheqja e Parakohshme	20
10.3.	Humbja e jetës së anëtarit	21
10.4.	Tërheqja e aktiveve nga llogaria individuale	21
11.	PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES SË ANËTARËSISË NË FONDIN E PENSIONIT	22
12.	TRANSFERIMI I LLOGARISË INDIVIDUALE	22

13.	PËRLLOGARITJET DHE FREKUENCA E VLERËSIMIT TË AKTIVEVE, VLERËS NETO TË AKTIVEVE DHE ÇMIMIT	23
14.	PUBLIKIMI I TË DHËNAVE DHE INFORMIMI I ANËTARËVE	24
15.	KOMISIONET E SHOQËRISË ADMINISTRUESE	25
15.1.	Komisioni vjetor i administrimit:.....	25
15.2.	Komisione të tjera:	25
16.	BASHKIMI, NDARJA DHE SHNDËRRIMI I FONDEVE	26
17.	LIKUIDIMI VULLNETAR DHE I DETYRUAR I SHOQËRISË ADMINISTRUESE	28
17.1.	Likuidimi i shoqërisë administruese	28
17.2.	Likuidimi vullnetar i Shoqërisë Administruese	28
17.3.	Likuidimi i detyrueshëm i shoqërisë administruese	30
17.3.1.	Hapja e procedurave të likuidimit të detyrueshëm.....	30
17.3.2.	Vendimi për likuidimin e detyrueshëm.....	30
17.3.3.	Emërimi i likuidatorëve	30
17.3.4.	Pasoja e likuidimit të detyrueshëm	31
17.3.5.	Detyrimet dhe të drejtat e likuiduesit	31
17.3.6.	Rendi i përmbushjes së pretendimeve.....	32
17.3.7.	Raporti i likuiduesit.....	33
18.	BANKA DEPOZITARE.....	33
19.	AUDITUESI I JASHTËM	35
20.	ANKESAT	36
21.	FONDET NËN ADMINISTRIM.....	36
22.	ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE.....	37
22.1.	Asambleja e aksionarëve:.....	37
22.2.	Këshilli i administrimit:	37
22.3.	Administratorët:	39
22.4.	Delegimi i disa funksioneve të shoqërisë Administruese tek palët e treta	39
22.5.	Struktura Organizative	41
23.	ANEKSI 1 - SHEMBUJ ILUSTRATIVË TË FONDIT TË PENSIONIT.....	1

Emërtimi i Fondit:	Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur “Smart Pension” në monedhën bazë Lekë (në vijim “Fondi”)
Shoqëria Administruese:	Albsig Invest sh.a - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kollective (në vijim “Shoqëria Administruese”) e themeluar më datë 04.10.2019 dhe e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më datë 08.10.2019, NIPT L92208025J, me seli në adresën: "Downtown One", Bulevardi "Bajram Curri", HQ 1010, Tiranë, Shqipëri.
Data e miratimit të prospektit : të parë	Fondi u miratua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me vendimin nr. 96, datë 28/04/2022
Data e Fillimit të Veprimtarisë:	12 /01/2023
Data e Miratimit të fundit:	29.04.2025

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Prospekti është dokumenti kryesor që kontribuesit duhet të lexojnë për t’u njohur me karakteristikat e Fondit, parimet e investimit si dhe rregullat që do të shoqërojnë anëtarësimin në Fond.

Ligji nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, (në vijim “Ligji”) dhe aktet nënligjore që pasojnë atë janë baza e aktivitetit dhe operacioneve të Fondit.

Fondi i Pensionit Privat, është një alternativë për të pasur të ardhura shtesë përveç Pensionit shtetëror. Fondi është krijuar me qëllim plotësimin e sistemit shtetëror të Pensioneve, ku si rrjedhojë e rritjes së jetëgjatësisë dhe problematikave të tjera, nuk u siguron të ardhura të mjaftueshme një pjese të madhe të popullsisë në moshën e Pensionit.

Një Fond Pensioni Privat është një grup i veçuar aktivesh, pa personalitet juridik, i miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe i administruar nga një shoqëri Administruese për llogari të anëtarëve të Fondit në përputhje me dispozitat e Ligjit. Fondi i Pensionit Privat mund të jetë me pjesëmarrje të hapur ose me pjesëmarrje të mbyllur. Fondi i Pensionit me pjesëmarrje të hapur është Fondi i Pensionit i krijuar nga Shoqëria Administruese, anëtar i të cilit mund të jetë çdo individ, përfshirë punëmarrësit e punëdhënësit, i cili zgjedh të

kontribuojë në Fondin e ofruar nga Shoqëria Administruese, pa krijuar një Fond me pjesëmarrje të mbyllur.

Fondi menaxhohet nga Shoqëria Administruese, për t'u siguruar anëtarëve të Fondit të ardhura në moshën e Pensionit. Ndër seksionet kryesore të Prospektit është politika e investimit, e cila tregon se ku do të investojë Fondi. Shoqëria Administruese duhet të kryejë investime vetëm në aktivet e treguara në seksionin e politikës së investimit. Anëtarët e mundshëm duhet të lexojnë me vëmendje se në çfarë aktivesh investon Fondi dhe të bëjnë zgjedhjen e duhur nëse toleranca e tyre për rrezik përkon me tiparet e aktiveve që do të investojë Fondi.

Fondi do të investojë kryesisht në tituj e borxhit (obligacione) afatgjatë të emetuar ose garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë. Tradicionalisht, titujt e borxhit (obligacionet) qeveritar janë titujt me rrezikun më të ulët ndër titujt e tjerë në tregun e kapitaleve. Në këtë mënyrë, Fondi i adresohet kryesisht klientëve me tolerancë të ulët rreziku.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), me adresë Rruga "Dora D'Istria", Nr.10 P.O. Box 8363, Tiranë, Shqipëri licencon dhe ushtron mbikëqyrjen mbi aktivitetin e Shoqërisë Administruese, të Fondit dhe Depozitarit të tij.

Shoqëria Administruese, krahas administrimit të Fondeve të Pensionit Privat, është e licencuar dhe për administrimin e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, sipas licencës nr. 5, datë 22.11.2019, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF).

Aktivet e Fondit janë tërësisht të ndara nga aktivet e Shoqërisë Administruese dhe të Fondeve të investimit që administrohen nga Shoqëria Administruese, nuk mund të jenë pjesë e procedurës së falimentimit të Shoqërisë Administruese dhe Fondi nuk mund të jetë pjesë e procedurës së falimentimit.

Aktivet e Fondit me pjesëmarrje të hapur janë tërësisht të ndara nga aktivet e Fondit me pjesëmarrje të mbyllur dhe nga aktivet e tjera të administruara nga Shoqëria Administruese.

Aktivet e Fondit nuk mund të jenë objekt i pretendimeve ose ekzekutimeve të kryera në emër dhe për llogari të kreditorëve të Shoqërisë Administruese. Organizimi dhe administrimi i Fondit kryhet ekskluzivisht nga Shoqëria Administruese dhe kjo e fundit është përgjegjëse për përmbajtjen e prospektit të Fondit.

Ky prospekt nuk përfaqëson ftesë për anëtarësim, por shërben si mjet informues lidhur me tiparet, karakteristikat dhe rreziqet që mbart anëtarësimi në një Fond Pensioni Privat.

Shoqëria Administruese është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar ndaj Anëtarit të Fondit nga veprime ose mosveprime të saj, nëse dokumentet ose informacioni i parashikuar në prospekt përmban të dhëna dhe informacione të pavërteta, ose të paplota.

2. PËRKUFIZIME

Aktive - janë tituj, para dhe pasuri të tjera, të cilat janë në pronësi të Anëtarit të Fondit të Pensionit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

AMF - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

Anëtar - është individ, i cili i bashkohet Fondit të Pensionit Privat në bazë të një kontrate anëtarësimi me Shoqërinë Administruese, në emër dhe në përfitim të të cilit është hapur një llogari Pensioni në Fondin e Pensionit Privat dhe që ka të drejtën e përfitimit në të ardhmen nga Fondi i Pensionit Privat;

Anëtar potencial - është individ, i cili ka të drejtë për t'u përfshirë në një Fond Pensioni Privat;

Depozitari - është banka e licencuar nga AMF-ja për të kryer si veprimtari ruajtjen e aktiveve të Fondit të Pensionit Privat, dhe detyrat dhe funksionet e përcaktuara në Ligj;

Fond Pensioni Privat - grup aktivesh në pronësi të anëtarëve të Fondit;

Fitim nga kapitali - të ardhurat nga diferenca e çmimit të aktiveve;

Këshilli i Administrimit - organi i Shoqërisë Administruese me funksione administrimi dhe mbikëqyrjeje;

Kontribues - Anëtari në Fond Pensioni Privat, punëdhënësi i tij ose çdo person i tretë që paguan kontributet e Pensionit në llogarinë e Pensionit të anëtarit të Fondit të Pensionit Privat;

Kuotë Pensioni - është pjesa përpjesëtimore e pronësisë në grupin e aktiveve të Fondit të Pensionit Privat. Të gjitha kuotat përfaqësojnë fraksione të barabarta pronësie të aktiveve të Fondit të Pensionit Privat dhe vlera totale e të gjitha kuotave të Fondit të Pensionit në çdo kohë është e barabartë me vlerën totale neto të aktiveve të këtij Fondi Pensioni Privat;

Kthim nga investimi - është rezultati, që merret nga investimi i aktiveve dhe fitimi nga kapitali;

Tituj – janë instrumente financiare, të cilat emetohen për qëllime fitimprurëse nëpërmjet administrimit të të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i tyre dhe janë të tregtueshme. Titujt përfshijnë pa kufizim aksionet e emetuara nga shoqëritë aksionare, obligacionet e shoqërive tregtare dhe të njëjstëve të vetëqeverisjes vendore, bonot e thesarit dhe obligacionet e emetuara nga qeveritë, dëftesat tregtare, aksionet ose kuotat e fondeve të investimit, si dhe instrumentet e tjera financiare, të krahasueshme me aksionet dhe obligacionet;

Obligacion - është titull afatmesëm ose afatgjatë borxhi, me afat maturimi më të gjatë se një vit, që detyron emetuesin t'i paguajë zotëruesit të obligacionit vlerën nominale dhe interesin në një apo disa këste, në një datë të caktuar;

Rating (vlerësim) i titujve - renditje e titujve, e kryer nga agjencitë ndërkombëtare të klasifikimit, sipas nivelit të rrezikut që lidhet me investimin në to dhe kthimin nga investimi¹;

Portofol - investimet e kryera me aktivet e Fondit;

Diversifikim - investim i aktiveve në instrumente të ndryshëm për të zvogëluar rrezikun nga investimi;

¹ Klasifikimi me A, A2 dhe A3 përfaqëson rrezik të ulët (pritshmëria për kthimin nga investimi është e ulët); B, BB dhe BBB përfaqëson rrezik mesatar; C konsiderohen me rrezik të lartë (kanë pritshmëri kthimi më të lartë nga investimi).

Drejtor i Investimeve - personi përgjegjës në Shoqërinë Administruese për administrimin e investimeve;

Menaxher i rrezikut - personi përgjegjës në Shoqërinë Administruese për administrimin e rrezikut;

Përfitime - janë pagesat në para, në formë Pensioni, të shumave që gjenden në llogarinë e Anëtarit të Fondit;

Persona kyç - janë individët të cilët, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi, përfaqësojnë shoqërinë Administruese dhe ushtrojnë funksione drejtuese, përfshirë administratorin dhe anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë dhe në rastin e Depozitarit drejtuesi i shërbimeve të Depozitarit;

Personel kyç - janë individët në poste të larta, të cilët janë përgjegjës për funksionet kyçe të Shoqërisë Administruese;

Shoqëri Administruese - shoqëri aksionare, e krijuar sipas ligjit nr. 9901/2008², i ndryshuar dhe e licencuar nga AMF-ja, për të administruar një ose disa Fonde Pensioni dhe/ose Sipërmarrje të Investimeve Kolektive;

Komisioni vjetor i administrimit - është komisioni që i paguhet Shoqërisë Administruese për menaxhimin e investimeve;

Transferimi i aktiveve - transferimi i aktiveve nga një Fond Pensioni në një Fond tjetër, pavarësisht nga Shoqëria që e administron atë;

Vlera Neto e Aktiveve - është vlera e aktiveve të Fondit pas zbritjes së shumës totale të detyrimeve në momentin e llogaritjes.

3. POLITIKA E INVESTIMIT DHE ADMINISTRIMI I RREZIKUT

3.1. Politika e Investimit

Politika e Investimit për çdo Fond nën menaxhimin e Shoqërisë Administruese miratohet nga Këshilli i Administrimit. Anëtarët njoftohen tre muaj përpara në mënyrë elektronike për çdo ndryshim thelbësor të saj. Elementi thelbësor i saj është shpërndarja strategjike, ku tregohet se në cilat aktive do të investohen kontributet e anëtarëve.

Drejtori i Investimeve është përgjegjës për implementimin e politikës së investimit të Fondit në përputhje me Ligjin, rregulloret për aktivet e lejuara, Prospektin dhe rregulloret e tjera të Shoqërisë Administruese. Nën asistencën e analistëve të investimit monitoron kushtet e tregjeve të kapitalit, kryen analizat e investimeve dhe kryen transaksione me tituj në përputhje me objektivin e Fondit dhe me limitet e rrezikut. Drejtori i Investimeve raporton te Këshilli i Administrimit mbi ecurinë e tregjeve të kapitalit, tregtimin e titujve dhe mbi performancën e Fondit.

Menaxheri i Rrezikut monitoron ekspozimet e çdo lloji rreziku që lidhet me Fondin dhe Shoqërinë Administruese. Kontrollon nëse çdo ekspozim dhe çdo transaksion është brenda limiteve të përcaktuara në rregulloret e brendshme të Shoqërisë Administruese dhe në

² Si dhe çdo ndryshimi apo zëvendësimi të mëvonshëm të tij.

rregulloret e nxjerra nga AMF-ja. Menaxheri i Rrezikut është përgjegjës për vlerësimin e aktiveve të Fondit. Menaxheri i Rrezikut bashkëpunon me Menaxherin e Portofolit për ndërtimin e strategjive të investimit dhe kryen analizën e atribuimit (arsyet pse dhe si ka rezultuar kjo normë kthimi) të performancës së Fondit. Menaxheri i Rrezikut raporton rregullisht pranë Këshillit të Administrimit. Çdo investim inicohet nga njësi e administrimit të investimeve (“front-office”) dhe aprovohet nga njësi e administrimit të rrezikut (njësi ndërmjetëse e administrimit të rrezikut).

Gjatë përpilimit të politikës së investimit, Shoqëria Administruese ka konsideruar ndërtimin e një Fondi me tolerancë të ulët rreziku (konservator) duke respektuar parimin e sigurisë, diversifikimit dhe mbajtjes së likuiditetit të përshtatshëm për investimet afatgjata. Politika e Investimit është në përputhje me rregulloren nr. 154 “Mbi rregullat e mëtejshme për investimet dhe veprimtarinë e Fondit të Pensionit Privat”. Fondi do të investojë kryesisht në tituj borxhi (obligacione) afatgjata të qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Elementi kryesor që shoqëron investimin për Pension është koha relativisht e gjatë që i duhet anëtarëve për të dalë në Pension.

Elementet kryesore të politikës së investimit:

- ✚ Objektivi: Rritje të të ardhurave duke ruajtur principalin.
- ✚ Toleranca për Rrezik: E ulët.
- ✚ Horizonti i Investimit: Afatgjatë (10-30 vjet).
- ✚ Likuiditeti: I ulët.
- ✚ Strategjia e Investimit: Fondi do të ndjekë strategjinë e investimit të aktiveve sipas detyrimeve. Fondi do të investojë kryesisht në tituj borxhi (obligacione) afatgjatë të emetuar ose garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë që përkojnë sa më afër me kohëzgjatjen e daljes në Pension të Anëtarëve.

Objektivi i investimit nënkupton synimin mbi normën e kthimit të Fondit dhe lidhet ngushtë me tolerancën që ka Fondi për rrezik³. Rritja e të ardhurave duke ruajtur principalin (ruajtjen e shumës fillestare të investuar), nënkupton investime në aktive me rrezik të ulët të kredisë (mospagimit të interesave apo principalit) siç karakterizohen titujt e borxhit të emetuar ose të garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, ku rreziku i mospagesës së interesave dhe principalit konsiderohet më i ulët ndër titujt e tjerë në tregjet e kapitalit.

Horizonti i investimit nënkupton kohëzgjatjen e qëndrimit në Fond të Anëtarëve e cila përkon me kohën që i duhet atyre për të dalë në Pension. Përgjithësisht kjo kohëzgjatje parashikohet e largët.

Nevoja për likuiditet për Fondet e Pensionit Privat është përgjithësisht e ulët pasi kohëzgjatja e investimit është afatgjatë dhe në Fond paguhet çdo muaj kontributet e Anëtarëve individualë, si dhe të punëmarrësve nga punëdhënësit e tyre.

³ Toleranca për rrezik ka një lidhje të drejtpërdrejtë me normën e kthimit të Fondit. Kjo tolerancë ndahet në e ulët, e mesme dhe e lartë. Një tolerancë e lartë për rrezik duhet të ketë një objektivi për një normë kthimi relativisht të lartë.

Për të zbutur riskun nga normat e interesit, Shoqëria Administruese zbaton parimin e menaxhimit të aktiveve sipas detyrimeve, ku përshtat kohëzgjatjen e daljes në Pension me kohëzgjatjen mesatare të investimeve. Rreziku nga normat e interesit përfaqësohet si hendeku midis kohëzgjatjes së daljes së Anëtarëve në Pension dhe kohëzgjatjes së aktiveve të Fondit. Shoqëria monitoron në mënyrë të vazhdueshme këtë hendek dhe kryen investimet përkatëse për uljen e këtij hendeku dhe për zbutjen e riskut nga normat e interesit.

3.2. Shpërndarja e Aktiveve

Duke u nisur nga këto tipare të investimit për Pension, Fondi ka ndërtuar shpërndarjen e aktiveve si më poshtë ku investon vetëm në aktivet e shfaqura në këtë shpërndarje:

KATEGORIA E AKTIVEVE	MAKSIMUM	MINIMUM	OBJEKTIVI
Tituj të emetuar ose të garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë.	100%	0%	99%
Mjete monetare dhe depozita në banka të licencuara në Republikën e Shqipërisë.	100%	0%	1%

Maksimumi dhe minimumi përfaqësojnë maksimumet dhe minimumet që mund të ekspozohet Fondi në llojet e aktiveve të shfaqura. Fondi nuk investon më shumë se 20% të vlerës së aktiveve të Fondit në depozita pranë një subjekti të vetëm. Objektivi shërben si shpërndarje strategjike e Fondit. Shpërndarja strategjike përfaqëson një shpërndarje që Fondi synon të arrijë dhe të mbajë afatgjatë në aktivet e shfaqura.

Shoqëria Administruese mund të marrë hua vetëm për llogari të Fondit deri në 5% të vlerës neto të aktiveve të Fondit; vetëm për qëllime likuiditeti dhe në baza të përkohshme. Shoqëria Administruese për llogari të Fondit mund të marrë hua nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes (REPO) për një periudhë që nuk i kalon 90 (nëntëdhjetë) ditë. Shoqëria Administruese raporton në Autoritet mbi huamarrjet për llogari të Fondit.

Politika e investimit e Fondit rishikohet nga Këshilli i Administrimit dhe çdo ndryshim miratohet nga ky Këshill dhe nga AMF-ja. Këto ndryshime ndodhin rrallë dhe nuk kanë synim ndryshime të mëdha në tolerancën për rrezik të Fondit, por shtime të klasave të aktiveve me synim rritjen e diversifikimit të Fondit. Këto ndryshime do t'i komunikohen Anëtarëve me postë elektronike dhe publikohen në Faqen Zyrtare të Internetit të Shoqërisë Administruese www.albsiginvest.al brenda 10 ditëve pas miratimit nga AMF-ja. Brenda 30 ditëve pune nga dita e njoftimit të Anëtarëve dhe publikimit të njoftimit, çdo Anëtar i Fondit mund të kërkojë ndryshimin e Fondit të Pensionit pa paguar komision transferimi. Çdo ndryshim i politikës së investimit do t'i njoftohet Anëtarëve, të paktën, 3 (tre) muaj përpara se ky ndryshim të hyjë në fuqi.

4. INFORMACIONI MBI FONDIN DHE PERFORMANCËN E TIJ


Shoqëria Administruese do të publikojë çdo ditë çmimin e kuotës dhe vlerën neto të aktiveve të Fondit të në faqen zyrtare të saj www.albsiginvest.al. Çdo Anëtar do t'i mundësohet një

llogari “Online” ku mund të shikojë në çdo kohë të dhënat mbi kontributet e paguara, çmimin e kuotës, performancën e Fondit në kohë dhe vlerën e tij totale neto.

Shoqëria Administruese publikon në Faqen e saj Zyrtare të Internetit pasqyrat financiare vjetore të audituara të Fondit të Pensionit dhe pasqyrat financiare për periudhat raportuese të ndërmjetme gjatë vitit ushtrimor të parashikuara nga ligji, si dhe ato akte që rregullojnë kontabilitetin dhe aplikimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

4.1. Të dhënat historike

Fondi ka filluar aktivitetin më 12 Janar 2023. Norma e kthimit vjetor neto për periudhën 01 Janar 2024 – 31 Dhjetor 2024 ka rezultuar 5.55%. Norma e kthimit neto e Fondit llogaritet duke zbritur komisionin e administrimit nga e ardhura bruto që rezulton nga investimi. Niveli i normës së kthimit neto në të ardhmen nuk është i garantuar, dhe do të varet nga ecuria e normave të kthimit të titujve të borxhit (obligacioneve) afatgjatë të emetuar ose garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, ku investon Fondi. Vlera neto e aktiveve më 31 Dhjetor 2024 rezultoi 63,878,763.52 Lekë. Norma e kthimit vjetor i përket datës 31 Dhjetor të çdo viti.



4.2. Shpërndarja e aktiveve më 31 Dhjetor 2024

KATEGORIA E AKTIVEVE	Vlera (në Lekë)	% ndaj Aktiveve	Objektivi
Tituj të emetuar dhe garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.	57,306,701	90%	99%
Llogari rrjedhëse dhe depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë.	6,651,384	10%	1%

Fondi është jashtë objektivit për datën 31 Dhjetor 2024 si pasojë e akumulimit të kontributeve të paguara nga anëtarët për t'i investuar në fillim të muajit Janar 2025. Pas këtij investimi, alokimi strategjik kthehet në objektiv.

5. RREZIQET KRYESORE TË INVESTIMIT NË FOND

Investimi në aktive financiare shoqërohet gjithmonë me rrezik duke qenë se rreziku nuk mund të shmanget asnjëherë plotësisht. Çdo aktiv financiar përmban një kombinim midis rrezikut dhe normës së kthimit, ku sa më i lartë të jetë rreziku aq më e lartë mund të jetë norma e kthimit.

Fondi është me kontribute të përcaktuara ku përfitimet nuk janë të garantuara dhe rrezikun e investimit e mbart Anëtari.

Fondi është ndërtuar për anëtarë të cilët kanë një aftësi të ulët që të mbajnë rrezik. Për rrjedhojë Fondi ka ndërtuar një politikë investimi me tolerancë të ulët rreziku.

Fondi i Pensionit Privat “Smart Pension”, duke investuar në tituj shtetërorë të emetuar dhe garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë ka një profil rreziku të lidhur ngushtë me rrezikun e qeverisë shqiptare. Titujt e borxhit të qeverisë së Republikës së Shqipërisë (obligacionet) janë të garantuara plotësisht nga Shteti Shqiptar dhe si të tilla ato kanë rrezik të ulët të mospagesës së kuponave apo të principalit (rreziku i kredisë). Këta tituj (obligacione) janë të ekspozuar ndaj ndryshimit të normave të interesit (rreziku nga normat e interesit), të cilat ndryshojnë sa herë Shteti Shqiptar kryen emetime të reja apo nga ndryshimi i vlerësimeve individuale të tregtarëve të këtyre titujve. Ndryshimi i normave të interesit sjell ndryshim të normës së kthimit të Fondit dhe të çdo Anëtari.

Tiparet e rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet Fondi dhe administrimi i tyre nga Shoqëria Administruese janë si më poshtë:

5.1. Rreziku i Tregut:

Rreziku i tregut nënkupton luhatjet e vlerave të titujve të borxhit (obligacioneve) afatgjatë si pasojë e ndryshimeve të normave të interesit. Rritja e normave të interesit sjell ulje të vlerës së aktivit financiar dhe ulja e normave sjell rritje të vlerës së aktivit financiar.

Shoqëria Administruese mat riskun ndaj normave të interesit si hendek i kohëzgjatjes mesatare midis aktiveve dhe detyrimeve. Shoqëria Administruese, duke përdorur metodën e investimit të aktiveve sipas detyrimeve, zbut ndjeshëm ekspozimin e Fondit ndaj rrezikut të normave të interesit duke i konsideruar si “detyrime implicite” vlerën e aktiveve të Anëtarëve dhe kohën e tyre të daljes në Pension. Por nëse një Anëtar do të dalë nga Fondi i Pensionit përpara kohëzgjatjes së investimit (10-30 vjet), ai mund të ndikohet nga ky rrezik, nëse normat e interesit do të jenë rritur.

5.2. Rreziku i Inflacionit:

Investimi për një kohë të gjatë siç është dhe investimi për Pension shoqërohet me rrezikun e inflacionit, pasi rritja e përgjithshme e çmimeve zhvlerëson shumat e parave të marra në një kohë shumë të largët. Aktive me të ardhura fikse siç janë titujt e borxhit (obligacionet) nuk janë mbrojtës të mirë ndaj inflacionit. Për të përlllogaritur normën reale të kthimit, Anëtarë duhet të zbresë normën e inflacionit nga norma e tij e përfituar nga Fondi.

Shoqëria Administruese, këshillon anëtarët nëpërmjet një aplikacioni të brendshëm si të përcaktojnë dhe të monitorojnë një objektiv të tyre për Pension, duke kontrolluar në këtë mënyrë nëse Pensioni që do të përfitojnë do të jetë ose jo i mjaftueshëm. Anëtarët, të cilët dëshirojnë të monitorojnë një objektiv të caktuar për Pension janë të lutur të paraqiten pranë zyrave të Shoqërisë Administruese në adresën: "Downtown One", Bulevardi "Bajram Curri", HQ 1010, Tiranë, Shqipëri. nga e hëna në të premte në oraret 8:00 - 16:30, ose të na kontaktojnë në tel: +355 42254764.

5.3. Rreziku i Kredisë:

Rreziku i kredisë nënkupton mospagimin nga emetuesi të interesit periodik dhe/ose principalit. Gjithashtu përkeqësimi i aftësisë paguese të një emetuesi reflektohet në mënyrë të drejtpërdrejtë tek çmimi i titullit të borxhit (obligacionit) duke e ulur atë dhe duke ulur për rrjedhojë vlerën neto të aktiveve. Përkeqësimi i aftësisë paguese vjen zakonisht nga përkeqësimi i deficitit buxhetor.

Investimi në tituj borxhi (obligacione) të emetuar ose garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë është i lidhur me aftësitë paguese të Shtetit Shqiptar. Tradicionalisht, rreziku i kredisë vlerësohet shumë i ulët për titujt e borxhit (obligacionet) qeveritare.

5.4. Rreziku i Likuiditetit:

Rreziku i likuiditetit përbën pamundësinë për të shitur aktivet e Fondit në rast kur Shoqëria duhet të përmbushë detyrimet e saj për tërheqje nga Fondi ose rastin e shitjes së një aktivi me çmim të pafavorshëm. Investimi i Fondit në aktive jolikuide mund të sjellë ulje të normës së kthimit, kur aktivi shitet me një çmim të pafavorshëm.

Fondi, duke konsideruar që detyrimet e tij janë shumë afatgjata, të lidhura me daljen e Anëtarëve në Pension dhe duke konsideruar faktin që do të ketë çdo muaj hyrje nga skemat profesionale dhe individuale, nuk vlerëson si të domosdoshme mbajtjen e aktiveve me maturime të shkurtra apo të një shpërndarjeje të madhe në llogari monetare për nevoja likuiditeti që mund të vijnë nga tërheqjet. Shoqëria Administruese do të mbajë si mjete monetare dhe depozita bankare një shpërndarje strategjike prej 1%. Shoqëria Administruese mat dhe monitoron në frekuenca të rregullta rrezikun e likuiditetit të shprehur si hendeku që ekziston midis flukseve monetare dalëse dhe hyrëse (të aktiveve) të Fondit. Në varësi të kërkesave për likuiditet, Fondi mund të mbajë një pjesë të titujve të borxhit (obligacionet) në Fond, me vlerën e drejtë.

5.5. Rreziku Operacional:

Rreziku operacional përbën humbjet e mundshme nga gabime apo keqfunksionime të sistemeve të brendshme apo procedurave të Shoqërisë Administruese.

Shoqëria Administruese ndërton sisteme kontrolli dhe procedura të brendshme, duke parandaluar rrezikun e humbjeve të Fondit të shkaktuara nga gabime njerëzore, ose të sistemeve brenda shoqërisë; nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme, gabime ligjore ose të dokumentacionit, si dhe nga procedura e tregtimit, e vlerësimit dhe e pagesave në emër të Fondit. Për të administruar Fondin, Shoqëria, përdor një sistem operativ, i cili është ndërtuar duke respektuar parimin e katër syve. Gjithashtu Banka Depozitare kontrollon aktivitetin e investimeve dhe të transaksioneve me anëtarët (kontributet dhe shlyerjet).

5.6. Rreziku i Përputhshmërisë:

Rreziku i përputhshmërisë është mundësia e mospërmbushjes së akteve ligjore dhe rregulloreve që bien mbi to. Shoqëritë Administruese të Fondeve të Pensionit dhe të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive operojnë në një treg shumë të rregulluar. Ky rrezik mund të sjellë efekte negative për shkak të moszbatimit të rregulloreve, kryesisht ato që rregullojnë nivelin e kapitalit dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

Shoqëria Administruese ka ndërtuar bazën e plotë rregullatore të brendshme për të shmangur rrezikun e përputhshmërisë. Banka Depozitare gjithashtu kontrollon aktivitetin e investimeve dhe të transaksioneve me Anëtarët (kontributet dhe shlyerjet) nëse ky aktivitet është në përputhje me rregulloret dhe Prospektin.

Shoqëria Administruese ka ndërtuar një sistem solid të vlerësimit periodik të aktiveve, humbjeve të mundshme dhe mundësisë së rritjes së kapitalit. Në të njëjtën kohë do të informojë çdo Anëtar të Fondit në mënyrë elektronike për rregullat e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

5.7. Rreziku i Reputacionit:

Rreziku i reputacionit është një dëmtim i emrit të mirë të Shoqërisë Administruese, apo grupit ku ajo bën pjesë. Ky rrezik mund të vijë nga sjellja e Shoqërisë Administruese apo nga sjelljet e punonjësve të Shoqërisë Administruese.

Shoqëria Administruese ndjek parime të mirëqeverisjes të shprehura në rregulloren e brendshme të saj dhe ka ndërtuar rregulla për komunikimin dhe transparencën me klientët, të cilat garantojnë standarde të larta për mirëmbajtjen e reputacionit të Shoqërisë Administruese.

5.8. Rreziku i Agjencisë:

Rreziku i agjencisë ndodh kur administratorët e Shoqërisë Administruese apo dhe menaxherët e portofolit nuk marrin vendime për rritjen e fitimit afatgjatë të Shoqërisë Administruese apo në shërbim të klientit, por nisen nga synimet e tyre personale afatshkurtra.

Shoqëria Administruese ka ngritur rregullore të brendshme, të cilat vendosin rregulla mbi sjelljet e menaxherëve të portofolit dhe administratorëve të Shoqërisë Administruese. Banka Depozitare gjithashtu kontrollon procesin e investimeve dhe të transaksioneve të Anëtarëve dhe është një element i rëndësishëm kontrolli.

5.9. Rreziku i Ndryshimit të Tatimit:

Rreziku i ndryshimit të tatimit për Pensionet Private përfaqësohet nga ndryshimet e ardhshme në ligjet tatimore për Pensionet Private. Bazuar në dispozitat ligjore, anëtarët përfitojnë lehtësira tatimore që zbatohen në fazën e depozitimit të kontributeve dhe janë subjekt tatimi në fazën e përfitimit të Pensionit; me normën e tatimit në fuqi në atë periudhë. Në këtë aspekt, duhet mbajtur në konsideratë që norma e tatimit për Pensionet mund të ndryshojë.

5.10. Rreziku Ligjor:

Rreziku ligjor shfaqet si pasojë e ndryshimeve në legjislacionin shqiptar në lidhje me Fondet e Pensionit Privat. Ndryshime të tilla mund të sjellin trajtime të ndryshme të skemës aktuale; si në drejtimin e përfitimeve tatimore, ashtu dhe ndryshime në moshën e përfitimit të Pensionit.

5.11. Rreziku Politik:

Kriza të theksuara politike mund të sjellin përkeqësime të aftësisë paguese të Shtetit Shqiptar dhe për rrjedhojë uljen e vlerës së titujve të borxhit (obligacioneve) të emetuar.

5.12. Përmbledhja e ndikimit të rreziqeve

Rreziqet	Ndikimi në Fond	Ndikimi në Shoqërinë Administruese
Rreziku i Tregut	Mesëm	Ulët
Rreziku i Inflacionit	Mesëm	Ulët
Rreziku i Kredisë	Ulët	Ulët
Rreziku i Likuiditetit	Ulët	Ulët
Rreziku Operacional	Ulët	Ulët
Rreziku i Përputhshmërisë	Ulët	Ulët
Rreziku i Reputacionit	Ulët	Ulët
Rreziku i Agjencisë	Ulët	Ulët
Rreziku i Ndryshimit të Tatimit	Ulët	Ulët
Rreziku Ligjor	Ulët	Ulët
Rreziku Politik	Ulët	Ulët

6. PROCESI I ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT

Shoqëria Administruese ka ndërtuar mbi parime të qeverisjes së mirë, një sistem gjithëpërfshirës, efektiv dhe të pavarur për administrimin e rrezikut në përputhje me madhësinë, natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarisë së saj, i cili përfshin gjithashtu

administrimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Sistemi i administrimit të rrezikut miratohet nga Këshilli i Administrimit.

Sistemi i administrimit të rrezikut përmban:

- politikën dhe procedurat e administrimit të rrezikut;
- teknikat e matjes së rrezikut;
- monitorimin dhe raportimin e rrezikut

Shoqëria Administruese për një administrim sa më efektiv të rrezikut ka ndërmarrë këto masa:

1. Krijimin e burimeve të mjaftueshme për administrimin e rreziqeve;
2. Ndërtimin e politikave dhe procedurave të rrezikut që të jenë gjithëpërfshirëse, efektive dhe të pavarura;
3. Ndarjen e funksioneve operative dhe krijimin e kontrollove për çdo njësi;
4. Krijimin e një kulture ku administrimi i rrezikut të jetë përgjegjësi e çdo punonjësi;
5. Ndërtimin e një njësie të dedikuar për administrimin e rrezikut, e cila do të ushtrojë kontroll për çdo ekspozim të Shoqërisë Administruese dhe Fondeve nën menaxhim e cila;
 - 5.1 Monitoron ekspozimet dhe limitet e rrezikut;
 - 5.2 Monitoron çdo transaksion të instrumenteve financiare;
 - 5.3 Kontrollon nëse çdo transaksion kryhet në përputhje me rregullat dhe standardet më të mira;
 - 5.4 Parandalon dhe minimizon humbjet;
 - 5.5 Kryen analizën e atribuimit të performancës, e cila nxjerr arsyet pse dhe si ka rezultuar kjo normë kthimi e Fondit;
 - 5.6 Është përgjegjëse për metodologjinë e vlerësimit të aktiveve financiare;
6. Garanton besim tek anëtarët në Fond dhe te palët e treta duke ndjekur me përpikëri çdo rregullore dhe procedurë të brendshme;
7. Promovon praktikat dhe standardet më të mira në menaxhimin e Fondeve të Pensionit Privat.

7. ANËTARËSIMI DHE TË DREJTAT E ANËTARIT

Çdo person mund të anëtarësohet në Fond duke nënshkruar një kontratë anëtarësimi individual nëse do anëtarësohet në mënyrë individuale, apo një deklaratë për pranimin e pjesëmarrjes në një Fond Pensioni Privat të përzgjedhur nga punëdhënësi i tij. Sipas kontratës apo deklaratës së nënshkruar, Shoqëria Administruese do të hapë në regjistrin e Fondit një llogari personale për çdo Anëtar. Anëtari ka të drejtat e mëposhtme:

1. Anëtari brenda 30 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së kontributit të parë në llogarinë e Fondit mund të zgjidhë pa penaltet kontratën e anëtarësimit në Fond, pa përmendur arsye të veçanta, duke njoftuar me shkrim ose me postë elektronike Shoqërinë Administruese. Shoqëria Administruese duhet t'i kthejë Anëtarit vlerën e kontributeve të paguara në llogari, përfshirë kthimin nga investimi, përjashtuar komisionin e administrimit për atë periudhë.

2. Të ketë në çdo kohë pronësinë e aktiveve të investuara në Fond dhe një kthim nga investimi;
3. Të përfitojë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aktiveve ose pagesat periodike në formë Pensioni sipas kushteve dhe procedurave ligjore;
4. Të informohet të paktën 1 (një) herë në vit në mënyrë elektronike mbi gjendjen e llogarisë së Pensionit;
5. Të pajiset me dokumentin që vërteton pagesën e kontributeve në llogarinë e tij dhe konvertimin e tyre në kuota.
6. Të transferojë aktivet e akumuluar në një Fond tjetër, i cili administrohet nga e njëjta ose nga një Shoqëri Administruese tjetër. Në rastin e transferimit të aktiveve, Anëtari përfundon kontratën e mëparshme si dhe lidh një kontratë anëtarësimi në Fondin tjetër;
7. Të ketë një Fond Pensioni të trashëgueshëm në rastet kur Anëtari humb jetën.
8. Të përcaktojë masën e kontributeve që do të paguajë, frekuencën dhe mënyrën e pagesës së kontributit, të ndryshojë këtë shumë si dhe dinamikën e pagesës së kontributeve, sipas zgjedhjes.

8. KONTRIBUTET E ANËTARËVE NË FONDIN E PENSIONIT

Çmimi fillestar në datën e fillimit të aktivitetit të Fondit do të jetë 1,000 Lekë. Data e fillimit të aktivitetit të Fondit është data 12/01/2023. Çdo pagesë kontributesh do të kryhet në numrin e llogarinë së Fondit të Pensionit Privat Smart Pension IBAN **AL36 2051 1007 0008 03BL FIRL ALLF**, të hapur pranë Bankës Depozitare, Banka Kombëtare Tregtare sh.a (BKT), me të cilën Shoqëria Administruese ka lidhur një marrëveshje, e depozituar pranë AMF-së. Kontributi minimal për t'u derdhur nga çdo Anëtar do të jetë 1,000 (njëmijë) Lekë.

Pagesa e kontributeve bëhet në monedhën vendase Lekë, nga çdo person fizik që është Anëtar në Fond, ose nga çdo person i tretë, në emër dhe për llogari të Anëtarit, ose nga punëdhënësi (që ka lidhur kontratën me Shoqërinë Administruese), i cili kontribuon në emër dhe në dobi të punëmarrësve të tij.

Është e rëndësishme që Anëtari apo personi i tretë që kontribuon në emër të Anëtarit të vendosë numrin serial identifikues të Anëtarit në përshkrimin e transfertës drejt llogarisë së Fondit. Ky numër serial identifikon përfituesit e çdo pagese kontributesh.

Sipas marrëveshjeve, përveç kontributeve të paguara prej tij, punëdhënësi do të derdhë edhe kontributet individuale të punonjësve, duke ia zbritur nga paga bruto.

Pagesat e kontributeve mund të bëhen sipas kërkesës së Anëtarit (pagesë e menjëhershme, mujore, tre mujore, gjashtë mujore, vjetore ose në intervale të tjera).

Shoqëria Administruese konverton në kuotë Pensioni kontributet e investuara në Fond dhe aktivet e transferuara nga një Fond tjetër, sipas çmimit të kuotës të ditës së mbërritjes të pagesës së kontributit. Çdo kuotë Pensioni përfaqëson një pjesë përpjesëtimore pronësie në

secilën nga aktivet e Fondit. Vlera totale e kuotave në Fond është gjithmonë e barabartë me vlerën totale neto të aktiveve të Fondit.

Kuotat e Fondit janë të dematerializuara dhe mbahen në formë elektronike në regjistrin e pronësisë së Fondit. Regjistri i pronësisë së Fondit përbën dëshmi përfundimtare të të drejtave të anëtarëve mbi kuotat e regjistruara në të. Shoqëria Administruese është përgjegjëse të garantojë që regjistri të jetë i plotë, i saktë dhe i përditësuar. Shoqëria Administruese është përgjegjëse për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të kuotave të Fondit. Depozitari i Fondit mban njëkohësisht regjistrin e kuotave të Fondit, si dhe verifikon dhe kontrollon që çdo veprim i Shoqërisë Administruese në lidhje me këtë regjistër është në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Shembulli i blerjes së një kuote Pensionit:

Çmimi i kuotës së Pensionit	1,500 Lekë
Kontributi	30,000 Lekë
Numri i kuotave të Anëtarit në Fond: (30,000 Lekë / 1,500 Lekë)	20 kuota

Nëse pas një periudhe të caktuar çmimi i kuotës do të rritej në 1,600 Lekë, vlera e aktiveve të Anëtarit do të jetë e barabartë me $20 \text{ (kuota)} \times 1,600 \text{ Lekë} = 32,000 \text{ Lekë}$.

Kur një Anëtar në Fond ndërpret; përkohësisht apo përgjithmonë pagesën e kontributit; Ligji i jep të drejtë të mbetet Anëtar në Fond me të drejta si anëtarët e tjerë të Fondit.

9. TRAJTIMI TATIMOR

9.1. Lehtësitë tatimore për Anëtarin

Sipas legjislacionit fiskal në fuqi, ligji nr. 29/2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar dhe ligji nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”:

1. Kontributi i bërë nga çdo Anëtar në Fond zbritet nga të ardhurat personale të tij, për efekt llogaritje tatimi deri në limitin e përcaktuar sa paga minimale të miratuar në shkallë vendi;
2. Kthimi i investimit, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me aktivet e Fondit, nuk i nënshtrohen tatimit; as për vetë Fondin, dhe as për Shoqërinë Administruese;
3. Kontributet e bëra nga punëdhënësi dhe çdo kontribues tjetër, në emër dhe për llogari të Anëtarit të Fondit për efekte tatimore, nuk vlerësohen si të ardhura personale të Anëtarit;
4. Blerja e kuotave të Fondit është shërbim financiar dhe si rrjedhojë është e përjashtuar nga TVSH-ja;
5. Shërbimet e ofruara nga Depozitari për Shoqërinë Administruese dhe Anëtarët vlerësohen si shërbim financiar dhe si rrjedhojë përjashtohen nga TVSH-ja;
6. Pagesat e marra nga Anëtari në mënyrë periodike mujore për një afat më të madh se 2-vjeçar taten vetëm për kthimin nga investimi, me normën në fuqi të tatimit mbi të ardhurat personale;

7. Pagesat e marra nga Anëtari i Fondit në mënyrë të menjëhershme përpara afatit 2-vjeçar, të parashikuar në pikën 6 si më sipër, tatohen me normën në fuqi të tatimit sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat personale.
8. Blerja e një kontrate të sigurimit të jetës në formë “të përvitshme” nga një shoqëri sigurimi jete që sjell një produkt me të ardhura të rregullta periodike, do të trajtohet me të njëjtat lehtësi fiskale si pagesat periodike në formë Pensioni të parashikuara në pikën (6) si më sipër.

9.2. Lehtësitë tatimore për kontributet e bëra nga punëdhënësi

Kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij vlerësohen si shpenzim operativ, deri në shumën vjetore për çdo punëmarrës, të barabartë me pagën minimale vjetore të miratuar në shkallë vendi dhe kjo shumë vlerësohet shpenzim i njohur për qëllime të tatimit mbi fitimin;

10. PAGESA E PENSIONEVE

10.1. Pagesa e Pensioneve Sipas Parashikimeve në Ligj

Shoqëria Administruese do të ushtrojë edhe veprimtarinë e kryerjes së pagesave të Pensionit. Çdo Anëtar i Fondit, sipas zgjedhjes, ka të drejtë të përfitojë nga pagesa e menjëhershme e vlerës neto të aktiveve në llogarinë e vet, ose nga pagesa periodike në formë Pensioni, të cilat i përgjigjen kësaj vlere pa penalitet vetëm kur Anëtari përmbush kushtet e mëposhtme:

1. 5 vjet përpara se të mbushë moshën e Pensionit të parashikuar me ligj për sistemin e Pensionit të detyrueshëm;
2. Kur mbush moshën e Pensionit të parashikuar me ligj për sistemin e Pensionit të detyrueshëm që zbatohet për atë Anëtar;
3. Kur bëhet i paaftë për punë në mënyrë të përhershme dhe që vërtetohet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Me lindjen e së drejtës së marrjes së pagesës së Pensionit pa penalitet, aktivet e akumuluar mund të tërhiqen në format e mëposhtme:

1. Pagesë e menjëhershme;
2. Pagesë periodike mujore e planifikuar jo më pak se 2 (dy) vjet;
3. Përdorim i vlerës neto të aktiveve të llogarisë së vet për të blerë një kontratë të sigurimit të jetës në formë “të përvitshme” të lëshuar nga një shoqëri e sigurimit të jetës;
4. Kombinim i mënyrave të shprehura në pikat 1, 2 dhe 3 më sipër.

Anëtari që ka ushtruar të drejtën të marrë dhe/ose të përdorë vlerën neto të aktiveve të akumuluar sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 5 të Rregullores nr. 191, datë 1.11.2024, “Për Mënyrën, Afatet dhe Procedurën e Pagesës së Pensionit Privat”, nuk mund të vijojë të derdhë kontribute në Fond.

Pagesa e menjëhershme mund të jetë:

1. pagesë e plotë e vlerës neto të aktiveve në llogarinë e anëtarit;

2. pagesë e pjesshme e vlerës neto të aktiveve.

Në rastin e pagesës së pjesshme të vlerës neto të aktiveve, aktivet e mbetura të Anëtarit në llogarinë e Pensionit investohen në të njëjtën mënyrë si të gjitha aktivet e Fondit.

Pagesa e menjëhershme e vlerës neto të aktiveve do të kryhet në bazë të kërkesës me shkrim të Anëtarit, në llogarinë e tij, jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës së vlefshme në Shoqërinë Administruese. Konvertimi i kuotave në para në rastin e pagesave të menjëhershme, tërheqjeve të parakohshme dhe transferimit në një Fond tjetër do të kryhet me çmimin e kuotës së ditës së depozitimit të kërkesës së Anëtarit për tërheqje.

Pagesat periodike mujore në formë Pensioni do të kryhen mbështetur në një marrëveshje të veçantë që do të lidhet midis Anëtarit dhe Shoqërisë Administruese, kur Anëtari plotëson kushtet e parashikuara nga ligji për të përfituar Pension. Aktivet e mbetura të Anëtarit në llogarinë e Pensionit, pas çdo pagese periodike, investohen në të njëjtën mënyrë si të gjitha aktivet e Fondit. Pagesat periodike mujore në para të kuotave që gjenden në llogarinë individuale të anëtarit vlerësohen me çmimin e kuotës të ditës së njohjes së detyrimit të përcaktuar, në kontratën e nënshkruar mes palëve.

Më poshtë në Aneksin 1, ilustrohen me shembuj skenarë të ndryshëm se si ndikon kohëzgjatja e periudhës së investimit në Fond, norma e kthimit dhe madhësia e kontributit në shumën në dispozicion për Pension.

10.2. Tërheqja e Parakohshme

Kur Anëtari i Fondit kërkon të tërheqë aktivet e akumuluar në llogarinë e tij individuale pa përmbushur kriteret ligjore për të përfituar, do të konsiderohet tërheqje e parakohshme. Tërheqja e parakohshme shoqërohet me penalitetin e tërheqjes së parakohshme të parashikuar në rregulloren e AMF-së nr. 142, datë 28.08.2024, “ Për përcaktimin e penaliteteve të zbatuara në rastin e tërheqjes së parakohshme nga Fondi i Pensionit Privat.

Në rastin e tërheqjes së parakohshme do të aplikohen penalitete mbi vlerën neto të aktiveve të tërhequra dhe penaliteti do të llogaritet në raport me kohëzgjatjen e qëndrimit të Anëtarit në Fond. Më konkretisht penalitetet e parashikuara edhe në aktet nënligjore janë:

1. 2% e aktiveve të tërhequra, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer pas 20 vitesh nga data e kontributit të parë;
2. 5% e aktiveve të tërhequra, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon pas 10 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 20 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 20-të;
3. 10% e aktiveve të tërhequra, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon pas 5 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 10 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 10-të;
4. 15% e aktiveve të tërhequra, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore deri në 5 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 5-të.

Për tërheqjet e parakohshme, pagesa e menjëhershme e vlerës neto të aktiveve do të kryhet në bazë të kërkesës me shkrim të Anëtarit, në llogarinë e tij, jo më vonë se 30 ditë nga dita e mbërritjes së kërkesës së vlefshme në Shoqërinë Administruese.

10.3. Humbja e jetës së anëtarit

Nëse Anëtari humb jetën përpara se të marrë pagesën e të gjitha aktiveve të veta, aktivet në llogarinë e tij do t'i shpërndahen trashëgimtarëve, në përputhje me dispozitat ligjore, që rregullojnë trashëgiminë.

10.4. Tërheqja e aktiveve nga llogaria individuale

Në rastin e tërheqjes së shumës së menjëhershme të aktiveve të akumuluar, kur Anëtari ka mbushur kushtet ligjore për t'i tërhequr pa penalitet, në bazë të një kërkesë me shkrim nga Anëtari i Fondit, Shoqëria Administruese i paraqet urdhërin Bankës Depozitare në mënyrë që Banka të kryejë pagesën e totalit të aktiveve të akumuluar në llogarinë individuale të Anëtarit, brenda 15 ditësh nga dita e mbërritjes së kërkesës së vlefshme me shkrim.

Në rastin e pagesës periodike mujore të aktiveve të akumuluar, midis Anëtarit të Fondit dhe Shoqërisë Administruese do të nënshkruhet një marrëveshje mbi pagesat periodike. Anëtari i Fondit, në mënyrë të pavarur, përcakton shumën dhe frekuencat e pagesave periodike të cilat mund të ndryshohen me kërkesën e tij.

Periudha e zgjedhur nga Anëtari për përfitimin e aktiveve të akumuluar si pagesë mujore periodike nuk mund të jetë më pak se një deri në dy vjet. Anëtari përcakton datën e muajit të njohjes së detyrimit të pagesës periodike të Pensionit. Shoqëria Administruese është e detyruar që t'i dërgojë urdhër-pagesën Depozitarit, brenda 3 ditëve pune, nga data e njohjes së detyrimit.

Anëtari në Fond ka të drejtën të blejë një kontratë të sigurimit të jetës në formë “të përvitshme” duke lidhur një marrëveshje me një shoqëri të sigurimit të jetës, të cilën e zgjedh vetë. Në këtë rast, Shoqëria Administruese njofton shoqërinë e sigurimit të jetës për kërkesën e Anëtarit dhe merr një konfirmim nga kjo e fundit për blerjen e kontratës së sigurimit të jetës në formë “të përvitshme”. Shoqëria Administruese do të transferojë shumën e përcaktuar nga Anëtari në Fond, tek shoqëria e sigurimit të jetës e zgjedhur nga Anëtari, brenda 15 ditësh nga dita e mbërritjes së konfirmimit nga shoqëria e sigurimit.

Shoqëria Administruese njofton anëtarët e Fondit 3 muaj para lindjes së të drejtës për përdorimin e aktiveve neto në llogarinë e tij të Pensionit, së bashku me opsionet e pagesës, vlerësimin aktual të llogarisë individuale, dhe udhëzime për zbatimin e mënyrave të pagesës.

Shoqëria Administruese detyrohet t'i paguajë penalitet në formë interesi Anëtarit të Fondit në rastin e vonësive në pagimin e shumave të menjëhershme apo të pagesave periodike. Tarifa e penalitetit për çdo ditë vonese do llogaritet si raport i *Yield*-it i bonos së thesarit; 12 mujore të

ankandit më të fundit plus 5% me 365 ditë. Ditët e vonësës do fillojnë nga dita e parë e urdhrit për kryerjen e pagesës nga Fondi, deri në ditën kur kryhet pagesa.

11. PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES SË ANËTARËSISË NË FONDIN E PENSIONIT

Llogaria individuale e lidhur me Anëtarin në Fond përfundon atëherë kur:

1. Të gjitha aktivet e Anëtarit janë transferuar në një tjetër Fond Pensioni;
2. Në rastin kur Anëtari zgjedh të nënshkruajë një marrëveshje të veçantë me Shoqërinë Administruese për pagesat e Pensionit në formë periodike.
3. Nëse anëtari ka zgjedhur të marrë pagesën e Pensionit nëpërmjet një shoqërie sigurimi të jetës në formë “*të përvitshme*”.
4. Në rastin e tërheqjes së parakohshme.
5. Në rastin e humbjes së jetës së anëtarit.

12. TRANSFERIMI I LLOGARISË INDIVIDUALE

Anëtari i Fondit ka të drejtë, që në çdo kohë, të transferojë aktivet e veta nga një Fond Pensioni në një tjetër, i cili administrohet nga e njëjta ose nga një Shoqëri Administruese tjetër.

Anëtari, që ka vendosur të transferojë aktivet e veta në një Fond të ri Pensioni, duhet të njoftojë paraprakisht Shoqërinë Administruese të Fondit ekzistues për vendimin e tij. Në këtë rast kontrata me Shoqërinë e mëparshme Administruese do të përfundojë. Një kontratë e re do të nënshkruhet nga palët me Shoqërinë e re Administruese.

Në rastin e transferimit të aktiveve të Anëtarit në një Shoqëri tjetër Administruese, Shoqëria Administruese, me marrjen e kërkesës me shkrim nga anëtari për të transferuar aktivet, njofton brenda 5 ditëve pune Shoqërinë tjetër Administruese për kërkesën e Anëtarit për transferimin e aktiveve. Shoqëria Administruese ekzekuton transferimin e aktiveve në llogari brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së konfirmimit nga Shoqëria tjetër Administruese.

Në rastin e transferimit midis Fondeve të menaxhuara nga Shoqëria Administruese (nga e njëjta Shoqëri Administruese), transferimi ekzekutohet brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës nga Anëtari.

Brenda 5 ditëve pune nga dita e transferimit të llogarisë, Shoqëria Administruese informon Anëtarin për ekzekutimin e transferimit, vlerën totale neto të aktiveve të transferuara, përfshirë kthimin nga investimi, si dhe detyrimet e zbritura.

Transferimi i aktiveve në llogarinë e Anëtarit në një Fond Pensioni të administruar nga një Shoqëri tjetër Administruese shoqërohet me një komision transferimi deri në masën 0.5% të shumës së transferuar, ndërkohë që transferimi brenda Fondeve të menaxhuar nga e njëjta Shoqëri Administruese nuk shoqërohet me komision transferimi.

Transferimi nuk mund të kryhet nëse detyrimet e Anëtarit ndaj Fondit të mëparshëm nuk janë shlyer.

13. PËRLLOGARITJET DHE FREKUENCA E VLERËSIMIT TË AKTIVEVE, VLERËS NETO TË AKTIVEVE DHE ÇMIMIT

Metoda e vlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve të Fondit përgatitet nga Shoqëria Administruese, konsultohet me Depozitarin dhe bazohet në Ligjin dhe rregulloren e miratuar nga AMF-ja dhe parimet e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Pjesa më e madhe e titujve (obligacioneve) të emetuar ose garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë do të regjistrohen me anë të metodës së kostos së amortizuar (Held to Maturity sipas SNRF) duke përdorur interesin efektiv. Në varësi të kërkesave për likuiditet, Fondi mund të mbajë një pjesë të titujve të borxhit (obligacione) në Fond me vlerën e drejtë. Vlera e tregut e titujve të borxhit (obligacionet) që do regjistrohen me vlerën e drejtë do të llogaritet duke u mbështetur në Yield-in deri në maturim, i cili llogaritet me metodën e interpolimit linear sipas Yield-eve më të fundit të ankandëve të bonove dhe titujve të borxhit (obligacioneve) të qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe ditëve të mbetura deri në maturim të letrës me vlerë. Depozitat bankare vlerësohen sipas metodës së kostos së amortizuar.

Vlera neto e Fondit është vlera e aktiveve minus detyrimet e tij. Ndër detyrimet kryesore renditet komisioni vjetor i administrimit i Shoqërisë Administruese. Vlera neto për kuotë apo çmimi i një kuote llogaritet duke pjesëtuar vlerën neto të aktiveve të Fondit me numrin e kuotave të Fondit.

Kur faqja zyrtare e internetit ka probleme teknike dhe është i pamundur publikimi i vlerës neto të aktiveve të Fondit, çmimi i kuotës si dhe çdo informacion që lidhet me Fondin e Pensionit do publikohet në Faqen Zyrtare të Bursës Shqiptare të Titujve www.alse.al.

Vlera neto e aktiveve të Fondit dhe çmimi i një kuote do të llogariten nga Shoqëria Administruese në përputhje me politikat e miratura të kontabilitetit, si dhe me metodologjinë e vlerësimit, sipas Ligjit, rregulloret e miratura në bazë të tij dhe Prospektit. Përlllogaritjet do kryhen çdo ditë. Depozitari kontrollon dhe verifikon llogaritjen e vlerës neto të aktiveve të Fondit dhe çmimin e kuotës për përputhje me politikat kontabël dhe metodologjinë e vlerësimit, kuadron me Shoqërinë Administruese vlerën neto të aktiveve. Depozitari është përgjegjës për saktësinë e llogaritjes dhe nënshkruan dokumentin që përmban përcaktimin e vlerës së aktiveve, si dhe mban një kopje në dosjen e vet.

Dita e vlerësimit të aktiveve të Fondit (t-1) do të jetë një ditë para ditës (t) gjatë së cilës llogaritet vlera neto e aktiveve për kuotë. Vlera neto e aktiveve të Fondit, në ditën e vlerësimit (t-1), rezulton nga diferenca ndërmjet vlerës totale të aktiveve të Fondit të Pensionit në ditën (t-1), me totalin e detyrimeve të Fondit të Pensionit të po asaj dite (t-1). Ndër detyrimet kryesore renditet komisioni vjetor i administrimit. Çmimi i kuotës në ditën e vlerësimit (t-1) llogaritet

duke pjesëtuar vlerën neto të aktiveve të Fondit të ditës (t-1) me numrin total të kuotave të Fondit të po asaj dite (t-1).

Shoqëria Administruese është përgjegjëse për vlerësimin e saktë të aktiveve të Fondit, saktësinë e llogaritjes së vlerës neto të aktiveve dhe çmimin e kuotës.

Metodologjia e vlerësimit të aktiveve miratohet nga Shoqëria Administruese dhe nga Depozitari dhe depozitohet pranë AMF-së.

14. PUBLIKIMI I TË DHËNAVE DHE INFORMIMI I ANËTARËVE

Shoqëria Administruese do të publikojë vlerën (çmimin) e kuotës në Fond dhe Vlerën Neto të Aktiveve (VNA), çdo ditë në Faqen e saj Zyrtare të Internetit www.albsiginvest.al, pasi verifikohet nga Depozitari i Fondit.

Çdo Anëtar në Fond do të ketë akses për të parë të dhënat e llogarisë së tij individuale “Online” përmes një “përdoruesi” dhe “fjalëkalimi” në Faqen e saj Zyrtare të Internetit të Shoqërisë Administruese www.albsiginvest.al.

Ndryshime të rëndësishme të Prospektit i komunikohen Anëtarëve me postë elektronike dhe publikohen në Faqen e saj Zyrtare të Internetit të Shoqërisë Administruese, www.albsiginvest.al brenda 10 ditëve pune pas miratimit nga AMF-ja. Brenda 30 ditëve pune nga dita e njoftimit të Anëtarëve dhe publikimit të njoftimit, çdo Anëtar i Fondit mund të kërkojë ndryshimin e Fondit të Pensionit pa paguar komision transferimi. Ndryshime të rëndësishme përfshijnë: a) rritja e komisionit vjetor të administrimit, komisionit të transferimit, si dhe përfshirja e një komisioni të ri të padeklaruar më parë në prospekt; b) ndryshimi i objektivave të investimit dhe rreziqeve të lidhura me investimet e parashikuara; c) ndryshimi i profilit të rrezikut të Fondit të Pensionit ose aftësisë mbajtëse të rrezikut. Çdo rritje e komisioneve të zbatuara nga Shoqëria Administruese brenda kufirit të përcaktuar në ligj, do t'i njoftohet Anëtarëve të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara se ato të hyjnë në fuqi.

Shoqëria Administruese do të informojë të paktën 1 (një) herë në vit anëtarët me anë të postës elektronike për gjendjen e llogarisë së tyre individuale.

Të gjitha raportet gjashtë mujore dhe vjetore të Shoqërisë Administruese, si dhe raportet e Fondit, Prospektit, dhe çdo informacion shtesë, do të vihen në dispozicion të Anëtarit sipas kërkesës, pranë zyrave qendrore të Shoqërisë Administruese tek Bulevardi “Bajram Curri”, "Downtown One", Kati 16, Tiranë, Shqipëri. Gjithashtu këto materiale do jenë të disponueshme në faqen zyrtare të internetit www.albsiginvest.al dhe sipas kërkesës mundësohen edhe në formatin elektronik.

Prospekti dhe rregullat e Fondit i vihen në dispozicion Anëtarit pa pagesë nga Shoqëria Administruese dhe agjentët e Fondit të Pensionit, në formë të shtypur në letër përpara nënshkrimit të kontratës së anëtarësimit ose deklaratës së pranimi të pjesëmarrjes dhe, sipas kërkesës, i mundësohet edhe në format elektronik.

Anëtarët duhet të njoftojnë Shoqërinë Administruese nëpërmjet postës elektronike për çdo ndryshim të të dhënave të tyre të kontaktit dhe të dhënave personale si: adresa, numri i telefonit, mbiemri (duke vendosur ID-në e re), shtetësia etj.

15. KOMISIONET E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

15.1. Komisioni vjetor i administrimit:

Komisioni vjetor i administrimit do të jetë 1.2% (një pikë dy për qind) në vit e vlerës neto të aktiveve të Fondit. Komisioni i administrimit do të llogaritet në fund të çdo dite kalendarike të vitit financiar. Detyrimet për komisionin vjetor të administrimit do t'i paguhen Shoqërisë Administruese një herë në muaj, brenda dhjetë ditëve pune të muajit pasardhës.

Shembull i llogaritjes së komisionit vjetor të administrimit nga Shoqëria Administruese gjatë një viti:

Kontributi në fillim të periudhës (në Lekë)	50,000
Interesi i supozuar i rritjes së kontributit	6%
a) Vlera në fund të periudhës (në Lekë)	53,000
b) Komisioni vjetor i administrimit	1.5%
c) Komisioni vjetor i administrimit në vlerë nominale (a*b) (në Lekë)	795
Vlera Neto e Aktiveve në fund të periudhës (a-c) (në Lekë)	52,205

15.2. Komisione të tjera:

Fondit do t'i ngarkohen komisione të tjera si më poshtë:

- Komisioni i Depozitarit të Fondit. Komisioni do mbahet çdo ditë dhe do të paguhet çdo muaj si shumë e vlerave ditore për atë muaj, brenda 10 ditëve pune të muajit pasardhës.
- Tarifa e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) do të jetë 0.05% në vit e vlerës së aktiveve të Fondit. Komisioni do mbahet çdo ditë dhe do të paguhet çdo muaj si shumë e vlerave ditore për atë muaj.
- Komisioni vjetor i Audituesit të Jashtëm të Pasqyrave Financiare të Fondit (Audituesi Ligjor) do të jetë sipas marrëveshjes me Audituesin e Jashtëm të miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF). Ky komision do të mbahet çdo ditë dhe do të paguhet një herë në vit si shumë e vlerave ditore për vitin përkatës.
- Komisionet e transaksioneve me titujt në emër të Fondit, të cilat shpenzohen në momentin e kryerjes së transaksionit.

Kostoja totale vjetore që do t'i mbahet Fondit, sipas pikave 15.1 dhe 15.2 (komisioni vjetor i administrimit dhe kostot e paraqitura në pikën 15.2), nuk mund të kalojë në asnjë rast 1.5% të vlerës neto të aktiveve të Fondit. Çdo tejkalim i kësaj kostoje vjetore do të mbulohet nga Shoqëria Administruese.

Gjatë vitit financiar 01.01.2024-31.12.2024, Fondit i është mbajtur vetëm komisioni vjetor i administrimit prej 1.5% mbi vlerën neto të aktiveve.

Anëtarit mund t'i ngarkohen komisione dhe tarifa si më poshtë:

- Komisione bankare për transfertat e Fondeve sipas kushteve të bankave.

Çdo rritje e komisioneve që do të aplikohet nga Shoqëria Administruese brenda kufirit të përcaktuar në Ligj, do t'i njoftohet Anëtarëve në Fond të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara se rritja të hyjë në fuqi.

Shoqëria Administruese ka të drejtën e mos aplikimit të një ose disa komisioneve/tarifave për një afat të caktuar nëse këto komisione/tarifa ndikojnë në mënyrë disproporcionale në performancën e Fondit. Shoqëria Administruese do të monitoroj situatën e krijuar në tregjet e kapitalit dhe do të raportoj pranë Këshillit të Administrimit duke rekomanduar arsyet dhe masën e mos aplikimit të komisioneve të shoqëruar me periudhën e zbatimit. Mbas miratimit nga Këshilli i Administrimit, Shoqëria Administruese do të njoftoj AMF-në, anëtarët dhe do e publikoj në faqen zyrtare të internetit.

16. BASHKIMI, NDARJA DHE SHNDËRRIMI I FONDEVE

Dispozitat e Ligjit mbi bashkimin, ndarjen dhe shndërrimin e fondeve janë si më poshtë:

Bashkimi i fondeve

1. Bashkimi i fondeve të pensionit kryhet me transferim të një fond ekzistues ose nëpërmjet krijimit të një fondi të ri si më poshtë:

a. të gjitha të drejtat dhe detyrimet e një fondi/disa fondeve të pensionit (fond transferues) që bashkohen i kalojnë një fondi pensioni ekzistues (fond marrës). Anëtarët e fondeve të pensionit, pjesëmarrëse në bashkim, marrin kuotat në fondin marrës dhe fondet e pensionit pjesëmarrëse në bashkim prishen;

b. të gjitha të drejtat dhe detyrimet e një fondi/disa fondeve që bashkohen (fond transferues) i kalojnë një fondi pensioni marrës të krijuar rishtazi, anëtarët në fondet e pensionit pjesëmarrëse në bashkim marrin kuotat në fondin e pensionit marrës dhe fondet e pensionit pjesëmarrëse në bashkim prishen.

2. Pas bashkimit, vlera neto e aktiveve të fondit marrës duhet të jetë e barasvlershme me vlerën neto të aktiveve të fondit transferues.

3. Vlera totale e të gjitha kuotave, që zotëron anëtari në fondin marrës, pas ndryshimit të statusit të fondit si rezultat i bashkimit, duhet të jetë e barasvlershme me vlerën totale të kuotave që anëtari zotëronte në fondin transferues përpara ndryshimit të statusit.
4. Shoqëria administruese që administron fondin pas bashkimit do të vazhdojë të gjitha marrëdhëniet juridike që shoqëria administruese e fondit transferues kishte në emër dhe për llogari të fondit transferues

Ndarja e fondeve:

1. Ndarja e fondit të pensionit kryhet kur të gjitha të drejtat dhe detyrimet e një fondi pensioni transferohen në dy ose më shumë fonde marrëse dhe fondi transferues priset.
2. Ndarja e fondit, duke transferuar të drejtat dhe detyrimet në dy ose më shumë fonde ekzistuese, është ndarje me marrje në dorëzim. Ndarja e fondit, duke transferuar të drejtat dhe detyrimet në dy ose më shumë fonde, të krijuar për qëllim të ndarjes, është ndarje me themelim.
3. Fondi me pjesëmarrje të hapur mund të ndahet në vetëm dy ose më shumë fonde me pjesëmarrje të hapur, ndërsa fondi me pjesëmarrje të mbyllur mund të ndahet në fonde me pjesëmarrje të hapur ose fonde me pjesëmarrje të mbyllur.
4. Pas realizimit të ndarjes, vlera neto e aktiveve të fondit marrës duhet të jetë e barasvlershme me vlerën neto të aktiveve të fondit që ndahet.
5. Vlera totale e të gjitha kuotave, që zotëron anëtari në fondin marrës, pas ndryshimit të statusit të fondit si rezultat i ndarjes, duhet të jetë e barasvlershme me vlerën totale të kuotave që anëtari zotëronte në fondin e ndarë përpara ndryshimit të statusit.

Miratimi i bashkimit ose ndarjes së fondit të pensionit:

1. AMF miraton çdo kërkesë për bashkim ose ndarje të fondeve të pensionit privat. Kërkesa për miratimin e bashkimit ose ndarjes paraqitet nga shoqëria administruese e fondeve të pensionit.
2. Kërkesa për miratim shoqërohet nga:
 - a) projekt marrëveshja për bashkim ose ndarje;
 - b) opinionin e depozitarëve në zbatim të nenit 137 të Ligjit;
 - c) draftin informacioni që do t'u dërgohet anëtarëve në zbatim të nenit 138 të Ligjit;
 - d) prospektin e fondit dhe çdo rregull tjetër të fondit marrës;
 - e) dokumentacioni që dëshmon se është lidhur marrëveshja me depozitarin dhe audituesin lidhur me përgatitjen e konfirmimit pas vënies në zbatim të bashkimit ose ndarjes, sipas neneve 140 dhe 141 të Ligjit.
3. Autoriteti mund të kërkojë informacion shtesë, përveç informacionit dhe dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, brenda 10 ditëve pune pas marrjes së kërkesës. Autoriteti mund të kërkojë ndryshime në informacionet që u dërgohen anëtarëve, nëse informacionet nuk i përmbushin kërkesat e këtij ligji.
4. Kërkesa për bashkim shqyrtohet brenda 3 muajve pas depozitimit të kërkesës së plotë. Autoriteti jep miratimin nëse janë përmbushur dispozitat e kreut X të Ligji dhe nëse gjykohet se bashkimi ose ndarja e fondeve nuk do të cenojë interesat e anëtarëve.
5. Dispozitat e këtij kreu nuk zbatohen në lidhje me bashkimet ndërkufitare.

6. Shoqëria administruese është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar anëtarëve të fondit, për shkak të bashkimit ose ndarjes së fondit të pensionit, me përjashtim të rastit kur vërtetohet se ka vepruar me kujdesin e duhur dhe në interes të anëtarëve gjatë procesit të bashkimit ose ndarjes së fondeve të pensionit.

17. LIKUIDIMI VULLNETAR DHE I DETYRUAR I SHOQËRISË ADMINISTRUESE

17.1. Likuidimi i shoqërisë administruese

1. Likuidimi i shoqërisë administruese, kryhet vetëm pas miratimit të AMF-së.
2. Përveçse kur parashikohet ndryshe në Ligj, dispozitat e legjislationit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare zbatohen lidhur me procedurat e likuidimit vullnetar dhe të detyrueshëm të Shoqërive Administruese të themeluara në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të ligjit.
3. Kërkesa për miratimin e likuidimit vullnetar dhe mbylljes së Shoqërisë Administruese paraqitet në AMF nga këshilli i administrimit/mbikëqyrës i shoqërisë administruese.

17.2. Likuidimi vullnetar i Shoqërisë Administruese

1. Hapja e procedurës së likuidimit vullnetar bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë. Vendimi duhet të merret nga jo më pak se 75% e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të subjektit të licencuar.
2. Kërkesa për likuidim vullnetar i paraqitet për miratim AMF-së së bashku me dokumentet e mëposhtme:
 - a) vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë administruese lidhur me likuidimin;
 - b) arsyet e likuidimit;
 - c) emrat e propozuar të likuiduesve;
 - d) pasqyrën e audituar të aftësisë pagueuse;
 - e) një raport të hollësishëm për trajtimin e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë likuidimit, si dhe një vlerësim të kohëzgjatjes së procesit.
3. Si likuidator emërohen të paktën 2 persona fizikë, me miratim të Autoritetit, të cilët kanë përvojën dhe kualifikimet e kërkuara, si dhe janë të aftë dhe të përshtatshëm për kryerjen e detyrave;
4. Autoriteti merr vendim lidhur me kërkesën, sipas pikës 2 të këtij neni, brenda 3 muajve nga data e marrjes së kërkesës, së bashku me dokumentacionin e plotë. Autoriteti miraton likuidimin Vullnetar vetëm nëse gjykon se mund të paguhet të gjitha detyrimet kundrejt pronarëve dhe kreditorëve të shoqërisë. Gjatë kësaj periudhe, personat kyç të shoqërisë kryejnë detyrat e zakonshme, por nuk angazhohen në detyrime të reja kundrejt të tretëve.
5. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme nuk sjell pasoja juridike nëse AMF refuzon të japë miratimin për hapjen e procedurës së likuidimit Vullnetar.
6. Autoriteti publikon në faqen e tij të internetit vendimin e miratimit për hapjen e likuidimit Vullnetar.
7. Në rastet kur Autoriteti miraton procedurën e likuidimit Vullnetar, ai mund të vendosë:

- a) të kufizojë licencën për të ushtruar veprimtarinë e shoqërisë dhe të lejojë kryerjen e veprimtarive të përcaktuara ose ato veprimtari që janë të nevojshme për likuidimin Vullnetar;
 - b) të përcaktojë se deri në çfarë mase zbatohen rregullat e administrimit të rrezikut në shoqërinë në likuidim Vullnetar;
 - c) pavarësisht nga shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, AMF mund t’i kërkojë shoqërisë të ndërmarre masa të posaçme lidhur me mbrojtjen e anëtarëve të fondit.
8. Shoqëria në procedurë likuidimi vullnetar vijon të ekzistojë në mënyrë që të shlyejë shpenzimet dhe detyrimet kundrejt të tretëve, të shpërndajë aktivet dhe të kryejë veprimet e nevojshme për përfundimin e likuidimit vullnetar.
 9. Likuiduesit mund të shkarkohen dhe të zëvendësohen sipas të njëjtave kushte të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.
 10. Veprimtaria e likuiduesit merr të drejtat dhe detyrimet e administratorëve, që nga dita e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, likuiduesit i ushtrojnë të drejtat dhe detyrimet në mënyrë solidare në përputhje me Ligjin, me përjashtim të rastit kur akti i emërimit parashikon që likuiduesit të veprojnë të ndarë nga njëri-tjetri. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë operacione të një kategorie të veçantë. Likuiduesi është objekt i mbikëqyrjes nga Asambleja e Përgjithshme.
 11. Detyra e likuiduesve është të përmbyllin të gjitha operacionet e shoqërisë, të shesin aktivet e shoqërisë dhe të paguajnë kreditorët duke respektuar rendin e përmbushjes së pretendimeve sipas këtij ligji.
 12. Nëse në bazë të të drejtave të kërkueshme të kreditorëve, likuiduesit arrijnë në përfundimin që pasuria dhe aktivet e shoqërisë janë të pamjaftueshme për shlyerjen e këtyre të drejtave, likuiduesit pezullojnë procedurën e likuidimit dhe i kërkojnë gjykatës përkatëse hapjen e procedurës së falimentit.
 13. Likuiduesi harton një pasqyrë bilanci të situatës së shoqërisë pas emërimit të tij. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se 1 vit, likuiduesi harton edhe pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Pasqyra e bilancit miratohet me vendim të 1/2 së anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme.
 14. Likuiduesi i fton kreditorët e shoqërisë, duke përjashtuar aksionarët, të parashtrojnë pretendimet e tyre në likuidimin Vullnetar. Shoqëria e publikon 2 herë këtë njoftim, me një interval kohe prej 30 ditësh, në faqen e saj në internet, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit.
 15. Likuiduesi nuk i shpërndan aktivet e mbetura përpara përfundimit të afatit 3-mujor nga publikimi i thirrjes së dytë, drejtuar kreditorëve për ngritjen e pretendimeve të tyre.
 16. Nëse një detyrim nuk shlyhet dot menjëherë ose është objekt i pretendimeve të kërkueshme, aktivet mund të shpërndahen vetëm nëse kreditorit i është dhënë një garanci e përshtatshme.
 17. Pas shlyerjes së detyrimeve kundrejt kreditorëve dhe anëtarëve, likuiduesi ua shpërndan aktivet e mbetura në mënyrë përpjesëtimore aksionarëve.
 18. Pas pagimit të detyrimeve të shoqërisë kundrejt kreditorëve dhe aksionarëve, likuiduesi i dorëzon AMF-së brenda 12 muajve një raport për procedurën e likuidimit dhe një propozim për shpërblimin e punës së tij.
 19. Nëse AMF nuk e miraton raportin, likuiduesi ndjek rekomandimin e bërë nga AMF.
 20. Pas miratimit të raportit nga likuiduesi, AMF ia heq licencën e dhënë shoqërisë.

21. Pas heqjes të licencës nga AMF, likuiduesi njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon fushën për Qendrën Kombëtare të Biznesit.
22. Asnjë ankesë ose kundërshtim nuk mund të bëhet kundër veprimtarisë së likuiduesit pas përfundimit të çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
23. Aktivet e fondit të pensionit, që ka nën administrim një shoqëri administruese, nuk mund të jenë objekt ekzekutimi si pasojë e procedurave të likuidimit ose të falimentimit të shoqërisë administruese, sipas legjislacionit shqiptar, dhe as të shlyerjes apo të ekzekutimit të pretendimeve kundrejt shoqërisë administruese.

17.3. Likuidimi i detyrueshëm i shoqërisë administruese

17.3.1. Hapja e procedurave të likuidimit të detyrueshëm

1. AMF merr vendim për vendosjen në likuidim të detyrueshëm të shoqërisë administruese kur konstaton se ekzistojnë një ose më shumë prej rrethanave të mëposhtme:
 - a) shoqëria nuk është në gjendje të shlyejë detyrimet e veta brenda afatit;
 - b) shoqëria kryen ose ka kryer veprimtari në shkelje të këtij ligji;
 - c) autoriteti gjykon se është vendimi i duhur dhe i drejtë që shoqëria të ndërpresë veprimtarinë e saj;
 - d) kjo procedurë rekomandohet në kuadër të procesit të përfunduar të rimëkëmbjes dhe rehabilitimit.
2. AMF për të garantuar mbrojtjen e anëtarëve të fondit të pensionit, mund të kërkojë që fondi/et t'i kalohet/n një personi juridik tjetër të licencuar si shoqëri administruese për administrimin e fondeve të pensionit privat.

17.3.2. Vendimi për likuidimin e detyrueshëm

1. AMF vlerëson situatën dhe vendos lidhur me fillimin e procedurave të likuidimit të detyrueshëm.
2. AMF vendos shoqërinë administruese në likuidim të detyrueshëm menjëherë pasi arrin në një përfundim lidhur me rrethanat përkatëse të parashikuara në Ligj(Hapja e procedurave të likuidimit të detyrueshëm).
3. AMF publikon vendimin e vendosjes së shoqërisë në likuidim të detyrueshëm në faqen e tij të internetit.

17.3.3. Emërimi i likuidatorëve

1. AMF, bazuar në vendimin për të filluar procedurën e likuidimit, emëron dy a më shumë likuidatorë për të shitur dhe shpërndarë aktivet e shoqërisë. Likuiduesit janë persona fizikë, që janë të aftë dhe të përshtatshëm për të kryer detyrat e tyre dhe kanë përvojën dhe kualifikimet e nevojshme sipas Ligjit.
2. Procesi i likuidimit të detyrueshëm kryhet nga likuiduesit e emëruar nga AMF.
3. Likuiduesit zbatojnë kërkesat ligjore lidhur me ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit në zbatim të këtij ligji dhe të legjislacionit të zbatueshëm.

17.3.4. Pasoja e likuidimit të detyrueshëm

1. Vendosja e shoqërisë administruese në likuidim të detyrueshëm ka pasojat juridike të mëposhtme:
 - a) të gjitha kompetencat dhe detyrat e shoqërisë i transferohen AMF, e cila cakton likuiduesin për të shitur dhe shpërndarë aktivet e shoqërisë administruese në zbatim të Ligjit;
 - b) pezullimin e licencës së shoqërisë administruese, e cila nuk kryen veprimtari të reja, me përjashtim të atyre që kryhen në funksion të qëllimeve të parashikuara në shkronjën “a” të kësaj pike;
 - c) pezullimin dhe mosfillimin e proceseve ligjore dhe ekzekutimin e detyrueshëm të shoqërisë. Këto procedura nuk fillohen, pezullohen, me përjashtim kur AMF jep pëlqimin e saj dhe sipas kushteve të caktuara nga AMF;
 - d) pezullimin për një periudhë 6-mujore të së drejtës për kompensim për kreditorët e shoqërisë;
 - e) nuk paguhet asnjë interes apo borxh tjetër i shoqërisë, me përjashtim të atyre që janë të nevojshme për të kryer ekzekutimin e rregullt të transaksioneve të tregut, në mënyrë që të parandalohet ndërprerja e funksionimit të sistemit financiar. Detyrimet ndaj kreditorëve shlyhen nga shitja e aktiveve të shoqërisë dhe në përputhje me pranimin e të drejtave të kërkuara, siç parashikohet në Ligj;
 - f) përfundimi i të gjitha kompetencave dhe përgjegjësi të asamblesë së aksionarëve dhe këshillit të shoqërisë.
2. Çdo veprim ligjor për kryerjen e pagesave ose për kalimin e titullit të pronësisë të shoqërisë quhet i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:
 - a) gjatë 3 muajve të fundit përpara se AMF të vendosë shoqërinë në likuidim të detyrueshëm; ose
 - b) gjatë 12 muajve përpara se AMF të marrë vendim për likuidimin e detyrueshëm, që favorizon përfituesit kundrejt kreditorëve të tjerë të shoqërisë;
 - c) përtej periudhave të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike në rastet kur likuiduesi vërteton se synimi ka qenë fshehja e pasurisë së shoqërisë nga kreditorët ose që veprimi ka ndikuar në mungesën e aftësisë paguese të shoqërisë.

17.3.5. Detyrimet dhe të drejtat e likuiduesit

1. Likuiduesi kryen administrimin dhe shitjen e aktiveve e të pasiveve dhe shpërndarjen e shumave të arkëtuara te kreditorët.
2. Likuiduesi bashkëpunon me AMF dhe zbaton udhëzimet e AMF-së lidhur me procesin e likuidimit të detyrueshëm.
3. Menjëherë pas emërimit, likuiduesi merr në kontroll shoqërinë, duke siguruar aktivet, librat dhe llogaritë e saj. Likuiduesi ka të drejtë akses në të gjitha aktivet, zyrat dhe librat e shoqërisë.
4. Likuiduesi bën inventar të aktiveve dhe pasurive të shoqërisë dhe harton një pasqyrë bilanci dhe relacion shpjegues lidhur me zërat e bilancit brenda 30 ditëve kalendarike pas fillimit të likuidimit, të cilat i dorëzohen AMF-së, ndërsa një kopje i vihet në dispozicion publikut.
5. Likuiduesi synon arritjen e shumës maksimale nga shitja e aktiveve të shoqërisë, duke kryer këto veprime:

- a) vijon ose ndërpret transaksionet financiare;
 - b) punëson nëpunësit, punonjësit ose këshilltarët e nevojshëm profesionalë;
 - c) nënshkruan akte në emër të shoqërisë dhe depoziton e ndjek kërkesëpadi në emër të saj pasi merr miratimin e AMF.
6. Likuiduesi ka të drejtë të zgjidhë:
- a) kontratat e punësimit me cilindo person;
 - b) kontratat e shërbimit në të cilat është palë shoqëria;
 - c) çdo detyrim tjetër, që lind nga kontratat e qirasë për pasuri të paluajtshme që ka shoqëria në cilësinë e qiramarrësit.
7. Brenda 1 muaji pas emërimit, likuiduesi vepron si më poshtë:
- a) u dërgon me postë të regjistruar të gjithë aksionarëve dhe kreditorëve, në adresat e shënuara në regjistrat e shoqërisë, një pasqyrë për natyrën dhe shumën e detyrimeve të pretenduara sipas regjistrave;
 - b) regjistron pretendimet e ngritura e të dokumentuara të kreditorëve.
8. Brenda 1 muaji pas datës së fundit të përcaktuar në njoftimin e dhënë, në bazë të pikës 7, për detyrimet e pretenduara likuiduesi:
- a) përcakton shumën, nëse ka, që shoqëria i detyrohet secilit kreditor të ditur;
 - b) përgatit për regjistrim pranë AMF-së një strukturë të detyrimeve të pretenduara.
9. Çdo kreditor ose aksionar, që përfaqëson të paktën 10% të aksioneve të emetuara, ka të drejtën të paraqesë kundërshtim lidhur me regjistrimin e detyrimeve të pashlyera pranë AMF-së brenda 20 ditëve pas regjistrimit të strukturës së detyrimeve të pretenduara, në përputhje me pikën 8. AMF merr vendim për pranimin ose refuzimin e kundërshtimit brenda 1 muaji nga data e regjistrimit të pretendimit.
10. Nëse kundërshtimi i parashikuar në pikën 9 pranohet, likuiduesi ndryshon dhe përmirëson përkatësisht strukturën e detyrimeve të pretenduara ose masat e propozuara për shlyerjen e detyrimeve.

17.3.6. Rendi i përmbushjes së pretendimeve

1. Likuiduesi shpërndan aktivet e shoqërisë duke shlyer detyrimet ndaj kreditorëve dhe aksionarëve sipas këtij rendi:
 - a) çdo kreditor i mbuluar me garanci kolaterali, i cili nuk mund të përdorë pasurinë me të cilën është garantuar detyrimi i tij për shkak të kufizimeve të përcaktuara me këtë ligj deri në shumën e të ardhurave nga shitja e kolateralit;
 - b) shpenzimet e likuiduesit dhe AMF-së të konstatuara në funksion të likuidimit të detyrueshëm;
 - c) pagat e punonjësve të shoqërisë, të mbajtur në punë nga likuiduesi, për ta asistuar në likuidimin e rregullt të fondit;
 - d) kreditorët e mbuluar dhe të pambuluar me garanci lidhur me vlerën e detyrimit, që e tejkalon vlerën e shitjes së kolateralit;
 - e) aksionarët.
2. Kur shumat për shlyerjen e kreditorëve me të njëjtin rend përparësie nuk është e mjaftueshme për t'i shlyer plotësisht këta kreditorë, atëherë ata shlyhen në mënyrë proporcionale me detyrimet ndaj tyre.

3. Çdo aktiv i mbetur pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve të pretenduara shpërndahet mes aksionarëve në përpjesëtim me të drejtat dhe pjesëmarrjen e tyre në kapital.

17.3.7. Raporti i likuiduesit

1. Likuiduesi i raporton AMF-së çdo muaj për ecurinë e procesit të likuidimit. Këto raporte përmbajnë informacione për shumën totale të pasiveve të kërkuara, shumën totale të aktiveve të shitura të shoqërisë administruese dhe të shumës së të ardhurave të pritura nga shitja e aktiveve.
2. Likuiduesi i paraqet një raport përfundimtar AMF-së pas mbylljes së procesit të likuidimit.

18. BANKA DEPOZITARE

Shoqëria Administruese ka lidhur një marrëveshje për shërbimin e Depozitarit me Bankën Kombëtare Tregtare sh.a. (BKT) regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar me vendim nr. 17469, datë 23.07.1997 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, NIPT J62001011Q, me seli në adresën rruga e “Vilave Lundër” Nr.1, Tiranë, që vepron si bankë me Licencën nr. 6/1998, datë 11.01.1999 e lëshuar nga Banka e Shqipërisë. Gjithashtu në bazë të vendimit nr.75, datë 07.10.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, është licencuar për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit. BKT ushtron veprimtarinë e Depozitarit të Fondeve të Pensionit Privat, bazuar në licencën nr. 4, datë 21.12.2015 (pa afat) të lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të ofruar shërbime depozitimi për aktivet e Fondit të Pensionit.

Depozitari kryen këto detyra:

- a) mban dhe regjistron aktivet e Fondit;
- b) monitoron vazhdimisht flukset e mjeteve monetare të Fondit dhe në veçanti garanton se janë arkëtuar të gjitha pagesat e bëra nga Anëtari ose në emër të Anëtarit, dhe se të gjitha mjetet monetare të Fondit janë regjistruar në llogaritë e mjeteve monetare në emër të Fondit, Shoqërisë Administruese për llogari të Fondit ose të Depozitarit për llogari të Fondit;
- c) mban regjistrin e Anëtarëve të Fondit dhe të dhënat për çdo transferim për Fondet e Pensionit;
- d) mban llogari për aktivet e Fondit dhe siguron ndarjen e aktiveve për secilin Fond për të cilin ofron shërbimet e Depozitarit nga aktivet e Depozitarit dhe klientëve të tjerë të Depozitarit dhe Shoqërisë Administruese;
- e) kontrollon që aktivet e Fondit investohen në përputhje me objektivat dhe strategjinë e investimit të miratuar, dispozitat e Ligjit dhe rregulloreve të miratuara në zbatim të tij;
- f) informon AMF-në dhe Shoqërinë Administruese për procedurën e llogaritjes së vlerës së aktiveve dhe çmimit të kuotës së Fondit, konfirmon llogaritjen dhe siguron që llogaritja e vlerës neto të aktiveve të Fondit dhe çmimi i kuotës së Fondit janë kryer në përputhje me politikat e miratuara të kontabilitetit, metodologjitë e vlerësimit, si dhe në përputhje me Ligjin dhe rregulloret e miratuara në zbatim të tij;
- g) ekzekuton urdhrat e Shoqërisë Administruese në lidhje me transaksionet e aktiveve të Fondit, nëse këto nuk bien ndesh me Ligjin dhe rregulloret e miratuara në zbatim të tij;

- h) raporton te Shoqëria Administruese për veprimet tregtare në lidhje me aktivet e Fondit të besuara në kujdestari dhe ekzekuton urdhrat e Shoqërisë Administruese;
- i) garanton kthimin e çdo shume përkatëse të Fondit brenda afateve kohore të përcaktuara;
- j) siguron që të gjitha të ardhurat, që rrjedhin nga transaksionet me aktivet e Fondit, të dërgohen në llogarinë e Fondit brenda afateve të përcaktuara;
- k) garanton se të ardhurat e Fondit përdoren në përputhje me Ligjin dhe rregulloret e miratuara në zbatim të tij;
- l) sigurohet që kostot ose tarifat e paguara nga Fondi janë në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe rregulloret e miratuara në zbatim të tij;
- m) kryen të gjitha detyrat e tjera të parashikuara në kontratën për kryerjen e veprimtarisë së Depozitarit të Fondit.

Depozitari ka këto përgjegjësi mbi regjistrin e pronësisë së Fondit:

- a) mban njëkohësisht me Shoqërinë Administruese regjistrin e kuotave të Fondit, si dhe verifikon dhe kontrollon që çdo veprim i Shoqërisë Administruese në lidhje me veprimtaritë financiare në llogaritë e kuotave të Anëtarëve në këtë regjistër është në përputhje me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
- b) duhet të sigurojë që të gjitha transaksionet lidhur me Anëtarët e Fondit të Pensionit, të regjistrohen me saktësi në regjistër. Kjo përfshin pagesën e kontributeve, tërheqjet/shlyerjet e kuotave, transferimet e aktiveve neto të anëtarit në një Fond tjetër Pensioni dhe/ose te një shoqëri e sigurimit të jetës, si dhe çdo veprimtari tjetër financiare që lidhet me llogaritë e Anëtarëve;
- c) duhet të kryejë kontrole të rregullta të të dhënave duke identifikuar dhe korrigjuar çdo mospërputhje apo gabim në regjistrin e pronësisë së Fondit, pas komunikimit me Shoqërinë Administruese, me qëllim sigurimin e saktësisë dhe integritetit të të dhënave që lidhen me Anëtarët e Fondit të Pensionit Privat;
- d) duhet t'i raportojë menjëherë Shoqërisë Administruese çdo mospërputhje ose parregullsi të identifikuar gjatë procesit të verifikimit dhe duhet të ndërmarrë veprime korrigjuese pa vonesë;
- e) duhet të raportojë menjëherë në AMF çdo veprim të ndërmarrë nga Shoqëria Administruese që bie në kundërshtim me kërkesat e Ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij në rast të ndonjë problemi ose gabimi të identifikuar në regjistrin e pronësisë. Raportimi duhet të përfshijë informacion të detajuar mbi natyrën e problemit dhe masat e marra për ta adresuar;
- f) duhet të zbatojë masa sigurie për të mbrojtur të dhënat e regjistrit të pronësisë së Fondit dhe çdo dokumentacion në të, për të shmangur aksesin e paautorizuar;
- g) duhet të zbatojë masa, për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të regjistrit;
- h) është përgjegjës për të siguruar që çdo shkëmbim i të dhënave ose komunikim me palët e treta kryhet në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave;
- i) është përgjegjës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e sigurt të të dhënave personale dhe financiare të Anëtarëve të Fondit të Pensionit Privat;
- j) duhet të sigurojë ndarjen e regjistrit të pronësisë për secilin prej Fondeve të Pensionit Privat ndaj të cilit ofron shërbimet e Depozitarit;

- k) duhet të ruajë dhe të arkivojë të dhënat e regjistrit të pronësisë duke siguruar që ato të mbahen sipas afateve kohore që parashikohen në legjislacionin e zbatueshëm në fuqi;
- l) duhet të vendosë dhe zbatojë politika dhe procedura për të parandaluar aksesin e paautorizuar në regjistrin e pronësisë, duke përfshirë enkriptimin, ruajtjen e sigurt dhe procedurat e aksesit të kontrolluar;
- m) është përgjegjës ndaj shoqërisë Administruese, Fondit të Pensionit dhe ndaj Anëtarëve të Fondit për çdo humbje të shkaktuar nga vetë ai ose nga një palë e tretë së cilës i është deleguar ruajtja e aktiveve të Fondit;
- n) është përgjegjës për çdo humbje financiare apo dëm të shkaktuar ndaj Anëtarëve për shkak të pasaktësive apo aksesit të paautorizuar në informacionin e tyre.

Depozitari raporton menjëherë me shkrim në AMF çdo shkelje ose çdo dyshim të arsyeshëm për shkelje në Ligj, dhe të kontratës për kryerjen e veprimtarisë së Depozitarit të Fondit të lidhur me Shoqërinë Administruese. Në këtë rast, Depozitari informon AMF-në edhe për hapat e ndërmarrë nga depozitari për të ndrequr shkeljen sa më shpejt që të jetë e mundur dhe informon në lidhje me afatin për ndreqjen e shkeljes në fjalë. Depozitari informon më tej AMF-në nëse ndreqja është përmbushur brenda këtij afati.

Depozitari mban evidencat e nevojshme që i japin mundësi të jetë në përputhshmëri me kërkesat e Ligjit dhe i mban këto evidenca për një periudhë kohore sipas parashikimeve të legjislacionit të zbatueshëm në fuqi.

Depozitari i mban aktivet, veprimet dhe dokumentet e Fondit të ndara nga aktivet e veta, veprimet dhe dokumentet e tij.

Depozitari është dhe do të vijojë të mbetet tërësisht i pavarur nga Shoqëria Administruese dhe nga çdo palë tjetër që ka lidhje me Shoqërinë Administruese.

Banka Kombëtare Tregtare sh.a ka marrë masa që të mënjanojë çdo konflikt interesi gjatë kryerjes së funksionit të Depozitarit ndaj Shoqërisë Administruese Albsig Invest sh.a. Nëse në një transaksion nuk mund të shmangët konflikti i interesit, Depozitari njofton Shoqërinë Administruese dhe të dyja palët sigurohen që konflikti i interesit të raportohet, monitorohet dhe administrohet në mënyrë që të mos ndikojë në mënyrë të padëshiruar ndaj palëve. Të dyja palët sigurohen që të mos preken interesat e Anëtarëve në Fond.

19. AUDITUESI I JASHTËM

Audituesi i jashtëm i Shoqërisë Administruese dhe i Fondeve nën administrim është: RSM Albania AL sh.p.k, i regjistruar me vendim nr. 757, datë 16.09.2021, në Regjistrin Publik të IEKA.

Me seli në adresën: Rruga “ Elbasanit”, Pallati Edil Al-It, pranë Ambasadës Amerikane P.O.B. 1437, Tiranë, Shqipëri

NIPT: L92313035V

Tel: +355 4 23446 077

Auditues Ligjor të shoqërisë audituese janë:

1. Bujar Bendo;
2. Fatbardha Shtrepi;
3. Fatian Devija;
4. Elona Bisha.

Audituesi i Jashtëm miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

20. ANKESAT

Lutemi që çdo ankesë të dërgohet me shkrim në adresën e Shoqërisë Administruese tek: "Downtown One", Bulevardi "Bajram Curri", HQ 1010, Tiranë, Shqipëri duke përdorur formularin e paraqitur në Faqen Zyrtare www.albsiginvest.al ose me anë të postës elektronike te info@albsiginvest.al.

Shoqëria ka ndërtuar një procedurë të trajtimit të ankesave e cila i paraqitet AMF-së. Shoqëria Administruese brenda afatit prej 2 (dy) ditësh pune nga data e marrjes së ankesës, i dërgon ankuesit një njoftim të menjëhershëm me shkrim duke e informuar se e ka marrë ankesën dhe se po e trajton atë, si dhe do të informohet më pas për progresin e masave që merren për zgjidhjen e ankesës.

Gjithashtu, Shoqëria Administruese duhet, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pune pas pranimit të ankesës, t'i dërgojë ankuesit përgjigje me shkrim ku e informon se:

- a) pranon ankesën dhe, aty ku është e përshtatshme, ofron dëmshpërblim ose korrigjim; ose
- b) refuzon ankesën dhe jep arsye për këtë.

Nëse Shoqëria Administruese nuk e zgjidh ankesën brenda afatit të përcaktuar më sipër atëherë vepron sa më poshtë:

- a) I shpjegon ankuesit pse nuk është në gjendje të japë një përgjigje përfundimtare dhe e informon se kur pritet të japë një përgjigje të tillë, por pa tejkaluar afatin e 15 ditëve të tjera pune; ose
- b) Informon ankuesin se mund t'ia parashtrojë ankesën Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF).

21. FONDET NËN ADMINISTRIM

Shoqëria Administruese Albsig Invest sh.a. ka nën administrim Fondet e mëposhtme:

1. Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur Albsig (Ref. FP 4), miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me vendimin nr. 210, datë 22.11.2019.

2. Fondi i Investimit Albsig Standard (Kodi F1-B5), miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me vendimin nr. 255, datë 30.12.2019.
3. Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të hapur Smart Pension, miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me vendimin nr. 96, datë 28.04.2022.

22. ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Shoqëria Administruese Albsig Invest sh.a. është një shoqëri aksionare, e themeluar më datë 04.10.2019 dhe e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më datë 08.10.2019, NIPT: L92208025J, me seli në adresën: "Downtown One", Bulevardi "Bajram Curri", HQ 1010, Tiranë, Shqipëri. Aksionari i vetëm i Shoqërisë Administruese është Albsig Jetë sh.a., e cila zotëron 100% të aksioneve. Emri ligjor i Shoqërisë është: Albsig Invest sh.a. – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive.

Kapitali i nënshkruar dhe i paguar i Shoqërisë Administruese është 69,000,000 (gjashtëdhjetë e nëntë milionë) Lekë. Shoqëria Administruese Albsig Invest sh.a ka si objekt të aktivitetit të saj:

1. Mbledhjen, investimin dhe kryerjen e pagesave për Pension të Fondeve të Pensioneve Private, në përputhje me dispozitat ligjore, si dhe bazuar në licencën nr. 5, datë 22.11.2019, të miratuar me vendimin nr. 210 nga AMF-ja;
2. Krijimin dhe administrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive në përputhje me dispozitat ligjore, si dhe bazuar në licencën nr. 5, datë 22.11.2019, të miratuar me vendimin nr. 210 nga AMF-ja.

Organet drejtuese të Shoqërisë Administruese janë: Asambleja e Aksionarëve, Këshilli i Administrimit dhe Administratorët.

22.1. Asambleja e aksionarëve:

Asambleja e Aksionarëve përbëhet nga përfaqësuesi ligjor i aksionarit të vetëm të shoqërisë – Shoqëria e Sigurimit Albsig Jetë sh.a.

22.2. Këshilli i administrimit:

Këshilli i Administrimit është organi qendror i Shoqërisë Administruese, i cili kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare dhe zhvillimin e biznesit të Shoqërisë Administruese. Këshilli kujdeset që Shoqëria Administruese të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit, miraton politikat financiare, të investimit, Prospektin, etj. Këshilli i Administrimit miraton dhe mban përgjegjësi të plotë për përmbajtjen e Prospektit. Këshilli përbëhet nga 5 anëtarë si më poshtë:

1. Z. Irfan LAMI: Kryetar i Këshillit të Administrimit

Z. Irfan Lami ka karrierë të gjatë në fushën financiare që prej vitit 1995. Z. Lami ka eksperiencë disa vjeçare pranë ISSH në fushën e Pensioneve, financës dhe auditimit. Ka eksperiencë mbi 18 vjeçare në menaxhimin financiar dhe drejtimin e shoqërive të sigurimeve në Shqipëri dhe

Kosovë. Prej vitit 2015 është Drejtor i Departamentit të Financës së Shoqërisë së Sigurimit Albsig Sh.a. Z. Lami zotëron që nga viti 1995 diplomë universitare të integruar të nivelit të dytë në Financë nga Universiteti Bujqësor i Tiranës,. Z. Lami ka kryer trajnime të shumta në fushën e menaxhimit financiar dhe të administrimit të rrezikut. Z. Irfan Lami nuk është palë e lidhur me asnjë nga aksionarët dhe me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

2. Z. Dritan KASTRATI: Anëtar i Këshillit të Administrimit

Z. Dritan Kastrati ka një eksperiencë disa vjeçare pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, si specialist i trajtimit të dëmeve, sekretar i Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve/Komisioneve dhe administrimit të praktikave të BSHS. Z. Kastrati prej vitit 2015 është pjesë e Shoqërisë së Sigurimit Albsig sh.a si Drejtor i Departamentit të Dëmeve dhe Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm. Z. Kastrati zotëron diplomë master në Administrim Publik nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Z. Kastrati ka kryer trajnime të shumta në fushën e menaxhimit (publik dhe të shoqërive Private), të sigurimeve, trajtimit të dëmeve dhe administrimit të rrezikut. Z. Dritan Kastrati nuk është palë e lidhur me asnjë nga aksionarët dhe me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

3. Z. Elvis BEQIRI: Anëtar i Këshillit të Administrimit

Z. Elvis Beqiri prej vitit 2017 është pjesë e Shoqërisë Sigurimit Albsig sh.a si Drejtor i Sigurimit të Përgjegjësive. Z. Beqiri ka një eksperiencë 14 vjeçare në fushën bankare në pozicione të ndryshme si Drejtor Departamenti, Drejtues Dege, etj. Z. Beqiri zotëron diplomë Master në Administrim Biznes (MBA) nga Universiteti Polis dhe IPAG Business School, Paris. Z. Beqiri ka kryer trajnime të shumta në fushën e menaxhimit dhe financës. Z. Elvis Beqiri nuk është palë e lidhur me asnjë nga aksionarët dhe me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

4. Z. Elton KORBI: Anëtar i Këshillit të Administrimit

Z. Elton Korbi është aktualisht Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese Albsig Invest sh.a. Z. Korbi ka një eksperiencë mbi 13 vjeçare në sektorin bankar; në banka tregtare dhe në Bankën e Shqipërisë, në fushën e auditimit, mbikëqyrjes, kontabilitetit dhe analizës financiare. Z. Korbi zotëron diplomë universitare të integruar të nivelit të dytë në Financë nga Universiteti i Tiranës si dhe diplomë Master në Administrim Biznes (MBA) nga Universiteti Epoka. Z. Korbi nga viti 2015 është duke ndjekur studimet për marrjen e certifikatës AÇA (*Association of Chartered Certified Accountants*). Z. Korbi ka zhvilluar trajnime të shumta në fushën e auditimit, mbikëqyrjes, menaxhimit të rrezikut, menaxhimit financiar dhe buxhetimit nga institucione prestigjioze si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Deutsche Bundesbank, BaFIN, Banque de France, etj. Z. Elton Korbi nuk është palë e lidhur me asnjë nga aksionarët dhe me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

5. Z. Admir RAMADANI: Anëtar i Këshillit të Administrimit

Z. Admir Ramadani është aktualisht Drejtor i Investimeve dhe Zëvendës Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese Albsig Invest sh.a. Z. Ramadani ka një eksperiencë 13 vjeçare në sektorin bankar, nga të cilat 5 vite në fushën e investimeve si dhe 8 vite në fushën e menaxhimit të rreziqeve. Z. Ramadani zotëron dy diploma në Ekonomi dhe Matematikë nga

Universiteti Amerikan në Bullgari. Z. Ramadani zotëron titullin CFA (*Chartered Financial Analyst*) që nga Tetori, 2012. Z. Admir Ramadani nuk është palë e lidhur me asnjë nga aksionarët dhe me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

22.3. Administratorët:

Veprimtaria e përditshme e Shoqërisë Administruese menaxhohet nga Administratorët, të cilët janë edhe anëtarë të Këshillit të Administrimit. Administratorët organizojnë dhe menaxhojnë veprimtarinë e Shoqërisë Administruese, përgatisin dhe propozojnë për miratim në Këshillin e Administrimit politikat e biznesit, rregulloret dhe procedurat e brendshme, raportet e zhvillimit të biznesit si dhe raportet financiare, vendosin mbi të drejtat dhe detyrimet e punonjësve që rrjedhin nga kontratat e punës. Administratorët e Shoqërisë Administruese janë:

1. Z. Elton KORBI - Administrator i Përgjithshëm, Anëtar Ekzekutiv i Këshillit të Administrimit;
2. Z. Admir RAMADANI - Zëvendës Administrator i Përgjithshëm, Anëtar Ekzekutiv i Këshillit të Administrimit.

Z. Korbi është përgjegjës për njësinë e marrëdhënieve me klientët, marketingun, njësitë suportuese (financë, burime njerëzore, IT, dhe Aktuaritika) njësinë e administrimit të rrezikut në rolin e Menaxherit të Rrezikut, në rolin e përgjegjës për përputhshmërinë, dhe raporton te Këshilli i Administrimit për çështje të lidhura me këto njësi. Menaxheri i Rrezikut krijon një sistem të administrimit të rrezikut për Fondet në menaxhim, raporton pranë Këshillit të Administrimit, siguron që Shoqëria Administruese të veprojë në përputhshmëri me tolerancën për rrezik të miratuar nga Këshilli i Administrimit, zbaton sistemin e administrimit të rrezikut i cili mat, identifikon, monitoron, dhe menaxhon ekspozimet ndaj riskut të tregut, kredisë, likuiditetit, operacional etj. Drejtuesi i njësisë së PPP-së siguron mbarëvajtjen e procesit të regjistrimit të informacionit, selektimit, dhe raportimit sipas kërkesave ligjore mbi parandalimin e pastrimit të parave. Përgjegjësi i përputhshmërisë administron procesin e reflektimit të ndryshimeve ligjore dhe rregullatore në politikat dhe procedurat e Shoqërisë Administruese.

Z. Ramadani është përgjegjës për njësinë e administrimit të investimeve në rolin e Drejtorit të Investimeve dhe menaxhimit të operacioneve ditore të Fondeve dhe raporton te Këshilli i Administrimit në lidhje me këto njësi. Drejtori i Investimeve është përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të investimit të Fondeve nën menaxhim, kryen vlerësimin e investimeve, ndërton një portofol optimal, monitoron flukset e parasë dhe menaxhon riskun e likuiditetit për të përmbushur në çdo kohë kërkesat dhe nevojat e likuiditetit, asiston forcën shitëse në komunikimin me klientët, dhe asiston në zhvillimin e Fondeve të reja.

22.4. Delegimi i disa funksioneve të shoqërisë Administruese tek palët e treta

Shoqëria Administruese ka lidhur një kontratë për delegimin e disa funksioneve të saj me Shoqërinë e Sigurimit Albsig sh.a. në mënyrë që të shfrytëzojë kapacitetet e saj të konsoliduara.


Funksionet dhe shërbimet e deleguara janë si vijon:

-  Shërbimi i përputhshmërisë dhe ligjor;
-  Shërbimet mbështetëse si burimeve njerëzore, arkiva, protokolli, dhe prokurime;
-  Shërbimi i auditimit të brendshëm;
-  Shërbimi i komunikimit, marketingut, marrëdhënie me publikun;
-  Shërbimi i administrimit të teknologjisë së informacionit;
-  Shërbimi i kontabilitetit dhe financës;
-  Shërbimi i ofrimit dhe i promovimi të fondit të pensionit privat;

Funksioni i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Synimi i delegimit të këtyre funksioneve të mësipërme ka të bëjë me rritjen e efektivitetit, nisur edhe nga eksperiencia e Shoqërisë së Sigurimit Albsig sh.a në treg ku dallohet për cilësinë dhe besueshmërinë e shërbimeve të saj ndaj klientëve. Pavarësisht këtij delegimi, Shoqëria Administruese mban përgjegjësi të plotë për përmbushjen dhe mbarëvajtjen e çdo funksioni të deleguar. Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a ka marrë masa që të mënjanojë çdo konflikt interesi gjatë kryerjes së funksioneve të deleguara ndaj Shoqërisë Administruese Albsig Invest sh.a. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare informohet për çdo funksion të deleguar.

22.5. Struktura Organizative



23. ANEKSI 1 - SHEMBUJ ILUSTRATIVË TË FONDIT TË PENSIONIT

Shembujt janë ndërtuar vetëm për qëllime ilustruese dhe nuk duhet të merren për bazë për ndonjë pretendim apo garantim të rezultateve të tyre. Këta shembuj dhe të dhënat e paraqitura në ta janë verifikuar nga znj. Brikena Xhaja (Preni), e pajisur me autorizimin “aktuar i autorizuar” nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Shembulli 1:

Faza e Investimit për Pension		Faza e Marrjes së Pensionit me Pagesa Periodike	
Kontributet mujore	5,000.00 Lek	Fondet në dispozicion për Pension	4,178,632.00 Lek
Norma mesatare e interesit ndër vite	5%	Norma mesatare e interesit ndër vite	5%
Numri i viteve të investimit	30	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	20
Pagesë e menjëhershme	0	Numri i kësteve në vite	12
Totali i kontributeve të derdhura	1,800,000.00 Lek	Shuma e Pensionit mujor	27,577.12 Lek
Kontribute + interesa të akumuluar	4,178,632.00 Lek	Totali i interesit gjatë Pensionit	2,439,877.21 Lek

Shembulli 2:

Faza e Investimit për Pension		Faza e Marrjes së Pensionit me Pagesa Periodike	
Kontributet mujore	10,000.00 Lek	Fondet në dispozicion për Pension	8,357,264.00 Lek
Norma mesatare e interesit ndër vite	5%	Norma mesatare e interesit ndër vite	5%
Numri i viteve të investimit	30	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	20
Pagesë e menjëhershme	0	Numri i kësteve në vite	12
Totali i kontributeve të derdhura	3,600,000.00 Lek	Shuma e Pensionit mujor	55,154.24 Lek
Kontribute + interesa të akumuluar	8,357,264.00 Lek	Totali i interesit gjatë Pensionit	4,879,754.42 Lek

Shembulli 3:

Faza e Investimit për Pension		Faza e Marrjes së Pensionit me Pagesa Periodike	
Kontributet mujore	12,000.00 Lek	Fondet në dispozicion për Pension	5,572,213.00 Lek

Norma mesatare e interesit ndër vite	6%	Norma mesatare e interesit ndër vite	6%
Numri i viteve të investimit	20	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	20
Pagesë e menjëhershme	0	Numri i kësteve në vite	12
Totali i kontributeve të derdhura	2,880,000.00 Lek	Shuma e Pensionit mujor	39,921.06 Lek
Kontribute + interesa të akumuluar	5,572,213.00 Lek	Totali i interesit gjatë Pensionit	4,008,842.50 Lek

Shembulli 4:

Faza e Investimit për Pension		Faza e Marrjes së Pensionit me Pagesa Periodike	
Kontributet mujore	15,000.00 Lek	Fondet në dispozicion për Pension	10,445,444.00 Lek
Norma mesatare e interesit ndër vite	4%	Norma mesatare e interesit ndër vite	4%
Numri i viteve të investimit	30	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	20
Pagesë e menjëhershme	0	Numri i kësteve në vite	12
Totali i kontributeve të derdhura	5,400,000.00 Lek	Shuma e Pensionit mujor	63,297.34 Lek
Kontribute + interesa të akumuluar	10,445,444.00 Lek	Totali i interesit gjatë Pensionit	4,745,916.63 Lek

Shembulli 5:

Faza e Investimit për Pension		Faza e Marrjes së Pensionit me Pagesa Periodike	
Kontributet mujore	8,000.00 Lek	Fondet në dispozicion për Pension	11,153,555.00 Lek
Norma mesatare e interesit ndër vite	5%	Norma mesatare e interesit ndër vite	5%
Numri i viteve të investimit	30	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	20
Pagesë e menjëhershme	1,000,000.00 Lek	Numri i kësteve në vite	12
Totali i kontributeve të derdhura	3,880,000.00 Lek	Shuma e Pensionit mujor	73,608.53 Lek
Kontribute + interesa të akumuluar	11,153,555.00 Lek	Totali i interesit gjatë Pensionit	6,512,491.32 Lek